

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes



Mbrojtja

Viti i 90-të i botimit
Shkurt 2022/ Nr. 2



aaaaa

NIS PUNA PËR BAZËN AJRORE TË NATO-S NË KUÇOVË
Rama e Peleshi: Shqipëria, vlerë e shtuar e Aleancës

Përmbajtja

Numri 2

Marrëveshja

- 8** Kryeministri Rama: Sistemi i ri i mbrojtjes kibernetike, vlerë e shtuar për NATO-n

GJENERAL BRIGADE XHEBEXHIA, KOMANDANTI I RI I KM

- 10** Ministri Peleshi: Detyra jonë primare është mbrojtja dhe siguria kombëtare

MERR DETYRËN KOMANDANTI I RI I FORCËS AJRORE

- 12** Ministri i Mbrojtjes: I bindur që gjeneral brigade Pulaj do të jetë edhe më pranë problemeve

TAKIMI

- 16** Gjeneralmajor Begaj: Duhet gjetur rrugë dhe mundësi të cilat i shërbejnë rritjes dhe intensifikimit të marrëdhënieve midis FA

20 JANAR 1921-2022

- 26** Gëzuar 101-vjetorin e Armës së Xhenios shqiptare!

STAFI

ANJEZA MUSOLLARI
Shef i Sektorit të Botimeve
& Kryeredaktor

Gazetarë:
Mimoza GOLIKJA

Graphic Designer:
Afërdita HYSAJ

Redaktore/ korrektore:
Suela HODA



4 BAZA AJRORE E NATO-s NË KUÇOVË

Rama e Peleshi: Shqipëria, vlerë e shtuar e Aleancës

Nis puna për realizimin e projektit për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës dhe transformimit të saj në Bazë Ajrore Taktike të NATO-s...



7 VIZITË ZYRTARE NË ROMË

Peleshi: Shqipëria, mision kyç për ruajtjen e orientimit strategjik euroatlantik në rajon

Shqipëria ka mision kyç jo vetëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, por edhe orientimin strategjik euroatlantik në rajon. Kjo u konfirmua nga ministri...



12 BASHKËPUNIMI

Katërbëdhjetë efektivë, mes të cilëve katër nga Kosova, përfunduan Kursin XIII Bazë të Forcave Speciale

Katërbëdhjetë efektivë, mes të cilëve katër nga Kosova, përfunduan Kursin e XIII Bazë të Forcave Speciale. Në ceremoninë e organizuar me këtë...



22 INTERVISTË ME LEGJENDËN E BASKETBOLLIT

Gazmend Çaçi, legjenda e basketbollit në panteonin e yjeve të Partizanit

Gazmend Çaçi, basketbollist i ekipit të parë të Partizanit për 20 vjet, me 870 ndeshje në aktivitete kombëtare me 17.900 pikë të shënuara...

Organ Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

Mbrojtja



Botues:

Qendra e Kulturës, Medias,
Botimeve të Mbrojtjes dhe Muzeut
Drejtoria e Kulturës, Medias dhe
Botimeve të Mbrojtjes

Adresa:

Rruga e Dibrës/ Garnizoni "Skënderbej"

REVISTA MBROJTJA

Organ Qendror
i Ministrisë së Mbrojtjes
Viti i 90-të i botimit
Nr. 2/ 2022

© Ministria e Mbrojtjes

Materialet e publikuara në këtë
revistë nuk mund të riprodhohen
elektronikisht apo fizikisht e të
përdoren për qëllime përfitimi, pa
marrë autorizim nga botuesit e saj.

Revista mund të gjendet në formatin elektronik (pdf) në adresën:

<http://www.mbrojtja.gov.al/index.php/publikime/revista-mbrojtja>





NIS PUNA PËR BAZËN AJRORE TË NATO-S NË KUÇOVË

Rama e Peleshi: Shqipëria, vlerë e shtuar e Aleancës



Nis puna për realizimin e projektit për modernizimin e Bazës Ajrore të Kuçovës dhe transformimit të saj në

Bazë Ajrore Taktike të NATO-s. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast morën pjesë kryeministri Edi Rama, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së gjeneral-major Bajram Begaj, ambasadorja e SHBA-së Yuri Kim, ambasadorë të vendeve të tjera të akredituar në Tiranë.

RAMA: "Është shumë e rëndësishme të ruhet paqja dhe stabiliteti, për këtë arsye Shqipëria merr një rëndësi kritike në Ballkan. Këto janë fjalët e Tod Wallters, në një vlerësim të bërë prej tij mbi rëndësinë e vendit tonë si pikë ndikuese në Ballkanin Perëndimor dhe në Europë, gjatë një dokumentari të NATO-s për bazën e

Jemi dëshmitarë se sa shumë mosbesim ka pasur kur është dhënë lajmi atëherë se NATO do të ngrinte bazën e saj në Kuçovë. Kishte shumë që thoshin që asnjëherë ky moment nuk do të vinte, kur Kuçova do të shndërrohej në vendin ku do të zbatoheshin pesë projekte.

Kuçovës. Vendimi që mori NATO për ta përzgjedhur këtë mjedis, duke e transformuar në një bazë ajrore taktike të aleancës në ra-

Shndërrimi i Bazës Ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s, një mundësi e shkëlqyer për FA në ngritjen e kapaciteteve kombëtare dhe modernizimin e Forcës Ajrore





jon, konfirmon faktin se Shqipëria e vogël është një vlerë e shtuar në këtë aleancë, e cila bashkon vende që besojnë në disa vlera dhe parime për të cilat ia vlen të luftohet. Për ne lajmi i kësaj vendim-marrjeje të NATO-s ishte shumë i mirëseardhur, sepse jo vetëm krijonte një vlerë të re në infrastrukturën tonë të mbrojtjes, por përçonte edhe një energji të re në përpjekjen tonë për ta shfrytëzuar me sa më shumë inteligjencë dhe pragmatizëm pozicionin tonë strategjik, në aspektin gjeografik, dhe pozitën tonë në NATO në aspektin politik, por edhe ushtarak.

Jemi dëshmitarë se sa shumë mosbesim ka pasur kur është dhënë lajmi atëherë se NATO do të ngrinte bazën e saj në Kuçovë. Kishte shumë që thoshin që asnjëherë ky moment nuk do të vinte, kur Kuçova do të shndërrohej në vendin ku do të zbatoheshin pesë projekte. Dhe përveç investimeve, do të impaktohet edhe ekonomia, ndërsa në aspektin social zona e Kuçovës do të ketë një përfitim si të ardhur nga qielli. Është bërë zakon të përmendim ambasadorën e SHBA-së në vendin tonë, por këtë herë më duhet ta përmend se, falë angazhimit të drejtpërdrejtë të ambasadores Kim dhe strukturat e tjera përkatëse, jemi duke folur për një projekt që ka të bëjë me krijimin e një qendre ekselence të mbrojtjes kibernetike, jo vetëm për Shqipërinë,

por edhe për gjithë NATO-n.”

Kryeministri theksoi më tej rolin e stërvitjes “Defender 21”, duke shtuar se Shqipëria është në pozicionin më të favorshëm për ta rikthyer atë në vitin 2023. Shndërrimi i Bazës Ajrore të Kuçovës në bazë ajrore të NATO-s, u cilësua nga kryeministri Edi Rama si një mundësi e shkëlqyer për Forcat tona të Armatosura në ngritjen e kapaciteteve kombëtare dhe modernizimin e Forcës Ajrore.

Duke shprehur mirënjohjen, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, deklaroi se kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen pa rezerva të aleatëve tanë dhe lidërsipit civil-ushtarak të NATO: “Përzgjedhja e Shqipërisë për të zhvilluar këtë projekt, është dëshmi e qartë mbi aftësitë tashmë të konsoliduara të vendit tonë, për të marrë më shumë përgjegjësi dhe për të vazhduar me maturi angazhimin dhe kontributin tonë në arkitekturën e sigurisë së rajonit dhe më gjerë. Ndërtimi i kësaj baze në vendin tonë, është dhe mesazh i qartë që i dërgohet aktorëve të tjerë me qëllime jo-të mira në rajonin e Ballkanit Perëndimor. Rritja e pranisë perëndimore në gjithë rajonin tonë nuk do të lejojë depërtimin dhe influencën e këtyre rivalëve, që kanë agjenda dhe interesa të tjera, të ndryshme nga ato që ne besojmë dhe ndajmë. Projekte dhe iniciativa të tjera si kjo e Kuçovës janë më se

të mirëpritura në të ardhmen, dhe ne jemi besimplotë se zhvillime të tjera do të na ndjekin.” - theksoi ministri Peleshi.

Ministri i Mbrojtjes tha më tej se me përfundimin e rikonstruksionit dhe vënien në gatishmëri operacionale, Baza Ajrore Taktike e Kuçovës do të luajë një rol vendimtar në mbështetjen e NATO-s dhe vendeve aleate për t'u dislokuar me shpejtësi dhe efikasitet. Por, sipas ministrit Peleshi baza do të ketë impakt pozitiv edhe në fushën sociale dhe ekonomike për komunitetin që jeton pranë kësaj baze. Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, teksa e cilësoi një moment historik tha se: “Baza Ajrore Taktike e Kuçovës do të shndërrohet në një gjurmë të rëndësishme të prezencës së NATO-s dhe do të jetë në shërbim të stërvitjeve dhe operacioneve të ndryshme të Aleancës, duke qenë e gatshme 24 orë në 7 ditë të javës, si në kohë paqeje, ashtu edhe në kohë krize”.

Investimi në këtë bazë arrin vlerën e rreth 45,8 milion euro dhe konsiston në ndërtimin e depove të armatimit, ato të karburantit, stacioneve të armatimit, parkingut të avionëve, stacionit kundër avarive dhe zjarreve, rindërtimin e pistës dhe kullës së kontrollit. Punimet parashikohet të përfundojnë në vjeshtën e vitit 2023.

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, vizitë zyrtare në Romë

Peleshi: Shqipëria, mision kyç për ruajtjen e orientimit strategjik euroatlantik në rajon

“Kosova mbetet interes kombëtar për Shqipërinë, e cila tashmë me statusin e vendit anëtar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022-2023 do të llojë fuqishëm në rritjen e numrit të vendeve që njohin pavarësinë e saj!”.

Shqipëria ka mision kyç jo vetëm për ruajtjen e paqes dhe sigurisë, por edhe orientimin strategjik euroatlantik në rajon. Kjo u konfirmua nga ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi gjatë vizitës së tij zyrtare në Romë, ku u takua me homologun e tij, z. Lorenzo Guerini.

Në qendër të diskutimit të të dy ministrave të Mbrojtjes ishte bashkëpunimi mes dy vendeve në këtë fushë, i cili ndër vite rezulton shumë intensiv.

Nga ana e tij, ministri Peleshi e falënderoi për zemërsisht homologun Guerini për mbështetjen e pakushtëzuar të Italisë për Shqipërinë, në rrugën drejt Bashkimit Europian. Duke folur për situatën në Ballkanin Perëndimor, ministri Peleshi theksoi se: “Një përshkallëzim negativ i situatës rrezikon efektin domino për të gjithë rajonin. Në këtë drejtim, Shqipëria dhe shqiptarët në rajon kanë një mision kyç, jo vetëm për ruajtjen e paqes, sigurisë dhe prosperitetit, por edhe për të ruajtur orientimin strategjik euroatlantik të rajonit. Shqipëria është e përkushtuar të promovojë ‘Politikën e Dyerive të Hapura’, për të gjitha vendet e rajonit”. Zoti Peleshi falënderoi ministrin e Mbrojtjes së Republikës së Italisë, z.

Guerini për mbështetjen që Italia i jep Kosovës, si edhe për kontributin e Forcave të Armatosura italiane në KFOR: “Kosova mbetet interes kombëtar për Shqipërinë, e cila tashmë me statusin e vendit anëtar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për periudhën 2022-2023 do të llojë fuqishëm në rritjen e numrit të vendeve që njohin pavarësinë e saj!”.

Sa i përket bashkëpunimin në kuadër të NATO, të dy ministrat theksuan interesin e përbashkët për një vëmendje të madhe ndaj rreziqeve dhe sfidave që burojnë nga Drejtimi Strategjik Jugor i Aleancës. Me rëndësi u vlerësua rakordimi i qasjes mbi “Konceptin e Ri Strategjik të NATO-s”, i cili pritet të miratohet në Samitin e Madridit, në qershor. Ministrat e Mbrojtjes të Italisë dhe Shqipërisë ranë dakord për vijimin e bashkëpunimit dypalësh rreth sfidave të mbrojtjes kibernetike, apo edhe në fushën e arsimit apo trajnimit, për të cilat ministri Peleshi tha se hapin mjaft dritare mundësish për personelin shqiptar. Dy ministrat ranë dakord gjithashtu të zgjerojnë marrëveshjen aktuale në fushën e mjekësisë ushtarake.

Teksa e falënderoi për mikpritjen, ministri Peleshi e ftoi homologun e tij për një vizitë në Shqipëri.



Kryeministri Rama: Sistemi i ri i mbrojtjes kibernetike, vlerë e shtuar për NATO-n

“Në kohën që jetojmë avantazhi apo shansi i vendeve më pak të zhvilluara është i panjohur në histori, i paparë dhe dëgjuar në histori, falë teknologjisë”

Kryeministri Edi Rama deklaroi se Shqipëria ka si objektiv krijimin e Qendrës Kombëtare të Mbrojtjes Kibernetike, e cila do të jetë në shërbim të ushtrisë shqiptare por do të jetë njëkohësisht edhe një vlerë e shtuar për vetë NATO-n.

Kryeministri përshëndeti firmosjen e marrëveshjes për forcimin e sigurisë kibernetike në vend dhe rritjen e infrastrukturës dixhitale, me kompaninë “Jones International” drejtuar nga James Logan Jones Jr.

Kryeministri Rama vlerësoi se kjo marrëveshje synon ngritje në një nivel tjetër të të gjithë kapaciteteve digjitale dhe sistemit të mbrojtjes kibernetike të Republikës të Shqipërisë.

Rama tha se “këtu nuk është thjesht çështja për të ndërtuar një sërë sistemesh sigurie, por për të ndërtuar një sistem tërësor sigurie që nga ana tjetër të ketë mundësi të ofrojë një vlerë të shtuar edhe për NATO-n”.

“Në kohën që jetojmë avantazhi apo shansi i vendeve më pak të zhvilluara është i panjohur në histori, i paparë dhe dëgjuar në histori, falë teknologjisë. Paradoksisht, moszhvillimi i mjaftueshëm kthehet në avantazh dhe teknologjia në shans për të bërë kapërcime



të jashtëzakonshme, siç ndodhi me transformimin tërësor në shërbimet online në Shqipëri. Kjo do të mundësojë që këtë vit ne të bëjmë një ndërhyrje radikale në sistem, duke i mbyllur të gjitha sportelet fizike dhe duke u ofruar të gjitha shërbimet online. Marrëveshja e sotme do të sigurojë edhe një bazë të dhënash të garantuar të këtyre shërbimeve”,

-tha Rama.

Kryeministri vlerësoi se “sot jemi në një fazë të re të marrëdhënieve me SHBA-të dhe NATO-n”.

“Kemi disa investime të rëndësishme në infrastrukturën kritike dhe në aspektin strategjik, ku hyjnë edhe investimet në fushën e mbrojtjes dhe në këtë aspekt ne vlerësojmë shumë këtë mundësi bashkëpunimi, për të

adresuar dhe sfidën e madhe të ngritjes së një Qendre Kombëtare të Mbrojtjes Kibernetike”, -tha Rama.

Kjo qendër, siç tha kryeministri, do të jetë në shërbim të ushtrisë sonë dhe gjithë aspekteve që kanë të bëjnë me pjesën civile të shoqërisë.

“Kjo është një sfidë e jashtëzakonshme, por jemi të bindur se duke pasur edhe ndihmën, mbështetjen dhe eksperiencën e kurajën tuaj, ne do t’ia dalim të kemi një Qendër Kombëtare Sigurie Kibernetike, që të jetë edhe një vlerë e shtuar për vetë NATO-n, duke dhënë shërbime edhe përtej Republikës të Shqipërisë”, -tha Rama.

Kryeministri tha se “e vlerësoj shumë aspektin e marrëveshjes sonë që ka të bëjë edhe me garancinë se kapaciteti dëmprurës i individëve do të jetë shumë më i reduktuar”. Ai tha se një sistem i tërë i rritjes së cilësisë së burimeve njerëzore në gjithë rrjetin e njerëzve që merren me shërbime digjitale dhe mbrojtje kibernetike do të vihet në funksion.

“Po ashtu, do të ketë programe të posaçme, që eksperiencën juaj i disponon, për të siguruar se aftësia e çdo individi për të penetruar sistemin të jetë shumë e kufizuar. Sistemi do të ketë shumë mure mbrojtëse edhe nga ndërhyrja e individëve. Ky është një lajm shumë i mirë edhe për ata që u lënduan padrejtësisht nga dalja e të dhënave personale”, -tha Rama.

Kryeministri në përfundim tha se “marrëveshja e sotme” është e mirëseardhur për qytetarët duke iu referuar zhvillimeve të fundit. “Jam i bindur se e shikojnë me lehtësim përfshirjen tuaj personale në këtë përpjekje të qeverisë shqiptare. Ju falënderoj për besimin e kurajën që na jepni dhe falënderoj ekipin tuaj që ka dëshmuar vlerën e dobinë e tij në asistencën që na ka dhënë për të qenë të mbrojtur në sistemet tona kritike të energjisë. Tani të bëjmë së bashku që në pak vite, ne të jemi krenarë për sistemin e mbrojtjes kibernetike që kemi si një vend që po zhvillohet me shpejtësi në aspektin e teknologjisë, por edhe vend i vogël por dinjitoz i NATO-s”, -tha z. Rama, duke iu drejtuar James Logan Jones Jr.



FORCAT E ARMATOSURA

Ti ke forcën që nderon kombin

Ministri Peleshi: Të gjithë ata të rinj që do të bëhen pjesë e Forcave të Armatosura, si rezultat i këtij procesi rekrutimi, do të vlerësohen nga një sistem pagash që është ndër më të lartat në rajon

Nën kujdesin e veçantë të ministrit të Mbrojtjes, z. Niko Peleshi, i cili ka ndjekur hap pas hapi procesin e rekrutimit të të rinjve dhe të rejave për ushtarë/detarë të rinj, kjo fushatë po vazhdon në të gjithë vendin. Fushata e nisur nga Elbasani, Korça, Shkodra, Lushnja, Vlora, për të vazhduar në Durrës dhe gjithë Shqipërinë është një risi e ministrisë së Mbrojtjes, për të qenë më pranë të rinjve dhe për të hapur një derë që për shumë prej tyre ka qenë një ëndërr.

Mes tyre ministri Peleshi u shpreh: Pagë mujore dinjitoze si asnjëherë më parë, përgatitje fizike dhe profesionale e vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit sipas standardeve të NATO-s dhe përfitime të tjera për një karrierë të sigurt. Qeveria shqiptare e bën këtë për t’i treguar Aleancës se Shqipëria meriton të jetë anëtare e NATO-s, por edhe për të treguar ambicien për të qenë të krahasueshëm me vendet e tjera anëtare të kësaj aleance.

Reeth 400 vende të lira janë sot pranë FA-ve, për ushtarë dhe detarë aktivë. Për të gjithë të rinjtë apo të rejtat nga 18 deri në 27 vjeç.

Zgjidh një karrierë profesionale pranë Forcave të Armatosura të Shqipërisë dhe ndero kombin.

REGJISTROHU TANI DHE BËHU PJESË E FORCAVE TË ARMATOSURA.



Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia, komandanti i ri i KM

Ministri Peleshi: Detyra jonë primare është mbrojtja dhe siguria kombëtare

Gjeneral brigade Ilir Xhebexhia merr detyrën e komandantit të Komandës Mbështetëse në Forcat e Armatosura. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast ishin të pranishëm ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj dhe komandantë të forcave të FA-së.

Në fjalën e tij, ministri Niko Peleshi vlerësoi përkushtimin, seriozitetin dhe profesionalizmin, me të cilin, gjeneral brigade Ilir Xhebexhia ka kryer deri tani detyrën e komandantit të Forcës Detare.

Kjo Komandë është e pazëvendësueshme, bën një punë të jashtëzakonshme në atë që publiku e njih më së shumti, rolin përgjatë gjithë vitit të Forcave të Armatosura. Natyrisht që detyra jonë primare është mbrojtja dhe siguria kombëtare, por ne jemi këtu për të mbështetur edhe operacionet civile në rastet kur nevojitet dhe kur forca jonë e pakrahasueshme me asnjë forcë tjetër, pra forca e FA-ve të Republikës së Shqipërisë është e nevojshme për të shpëtuar jetë njerëzish, për t'i mbrojtur nga pasojat e fatkeqësive të ndryshme, operacione humanitare, operacione civile", - u shpreh ministri i Mbrojtjes, duke kujtuar se edhe kjo forcë u godit rëndë nga pandemia, e cila i mori jetën gjeneral brigade Ndrizim Sallakut.

"Natyrisht kjo komandë është e jashtëzakonshme nga rëndësia që

"Jemi këtu për të mbështetur edhe operacionet civile, forca e FA-ve të Republikës së Shqipërisë është e pakrahasueshme me asnjë forcë tjetër"



ka në mbështetjen e operacioneve brenda dhe jashtë vendit, tashmë ka fituar edhe një emër në hapësirën e NATO-s. Njësia jonë EOD, e cila shërben në Letoni prej vitesh me rrotacion çdo 6 muaj është një kapacitet i madh tashmë i njohur edhe nga shtetet e tjera dhe që, me të vërtetë, ndonëse jemi një vend i ri dhe i vogël në këtë aleancë, në këtë kapacitet specifik, kemi bërë emër shumë të mirë edhe kemi marrë falënderime. Kjo është pra rruga, përmes së cilës duhet të ecim: nga njëra anë duhet të forcojmë kapacitetet e brendshme dhe të jemi më të shkathët, më prezentë pranë qytetarëve, sa herë që të jetë e nevojshme, duke mbështetur operacione humanitare dhe civile, por edhe t'i zbardhim faqen Shqipërisë dhe FA-ve me kapacitetet tona të veçanta si ai EOD në Letoni, por dhe kudo tjetër. Situata që po kalojmë është një situatë me dinamika, e turbullt herë pas here, me sfida, ndaj ne duhet të jemi të përgatitur për më të keqen, për të mbështetur frontin e parë, siç është dhe misioni i kësaj komande.”, - theksoi ministri Peleshi.

Gjeneral brigade Ilir Xhebeuxia deri më tani ka shërbyer si komandant i Forcës Detare, ndërsa më herët ka mbajtur detyra të rëndësishme si zëvendëskomandant në Qendrën e Radiozbulimit, shef sektori i Operacioneve dhe Stërvitjes në Forcën Tokësore, drejtor i Drejtorisë së Operacioneve dhe Stërvitjes në Shtabin e Përgjithshëm të FA-së. Ai ka qenë edhe zëvendës përfaqësues ushtarak i RSH-së në NATO si dhe atashe ushtarak i RSH-së në Mbretërinë e Belgjikës, jo rezident në Republikën e Francës.



CEREMONIA

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në FA

Në praninë e ministrit të Mbrojtjes Niko Peleshi, shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj, komandantëve të forcave dhe atyre mbështetëse, kolegëve dhe familjes së gjeneral brigade Bitrit, u zhvillua në Ministrinë e Mbrojtjes ceremonia e vendosjes së gradës. Në fjalën e tij ministri Peleshi u shpreh i gëzuar që në kuadër të procesit të promovimit të ushtarakëve me gradë madhore, Forcave të Armatosura dhe “trupës” së gjeneralëve të promovuar pak javë më parë i shtohet dhe një gjeneral brigade. “Ishte një promovim i merituar. Në kuadër të Aleancës apo dhe në kuadrin rajonal kemi rol të rëndësishëm për të luajtur. Për këtë na duhet dije, na duhet forcë e kompletuar dhe përgjegjshmëri. Njerëz si gjeneral Bitri vijnë në kohën e duhur, në vendin e duhur dhe në pozicionin e duhur. Respektoj kontributin jetësor të gjeneral Bitrit në Forcat e Armatosura dhe inkurajoj ushtarakët e tjerë, dhe ata që tani rekrutohen, të



shohin këtë rrugëtim të suksesshëm dhe të motivohen”, - u shpreh ministri i Mbrojtjes. Gjeneral brigade Bitri duke ndarë emocionet me të pranishmit në ceremoni u shpreh: “Përjetoj emocionet e një ëndrre tek e cila guxova të besoja. Nderin dhe privilegjin që më bëhet sot ia dedikoj një “liste” të gjatë njerëzish me të cilët më lidhin 36 vite në Forcat e Armatosura. Faleminderit atyre me të cilët kam punuar e punoj. Me kanë ndihmuar e mësuar të çmoj integritetin, virtytin dhe moralin. Faleminderit atyre për të cilët kam punuar e punoj. Kanë qenë e janë shembuj frymëzimi e lidhësi. Më kanë dhënë besimin, më kanë mbështetur e ma kanë vlerësuar e për këtë ju jam edhe mirënjohës. Faleminderit familjes, në mënyrë të veçantë gjysmës time më të mirë Valbonës që ka sakrifikuar për të ma bërë më të lehtë punën, por dhe djalit dhe vajzës që megjithëse iu kam munguar më falin”.

Anija angleze “HMS Trent” ka zhvilluar një vizitë në Gjirin e Vlorës

Anija angleze “HMS Trent” ka zhvilluar një vizitë në Gjirin e Vlorës. Qëllimi i vizitës ishte kryesisht mbi arritjen e bashkëpunimit midis forcave tona detare dhe shkëmbimin e eksperiencave të ndryshme për operacione dhe detyra që kryejnë grupi i anijes.

Gjatë vizitës gjithashtu u realizua dhe një prezantim i përgjithshëm i anijes angleze dhe kapacitetit të saj.

Anija angleze “HMS Trent”, u vizitua në një takim nga



zëvendës ambasadori i Britanisë në Shqipëri, komandanti i Forcës Detare kundëradmiral Adnand Agastra, i shoqëruar dhe nga shefi i shtabit i Flotiljes Detare Pashaliman kapiteni i rangut të II Dritan Seraj. Gjithashtu pjesëmarrës ishin dhe disa oficerë të Forcës Detare të Shqipërisë, të cilët kanë përfunduar studimet në Akademinë Detare në Mbretërinë e Bashkuar, bashkëpunim mbi të cilin u shpreh interes dhe gatishmëri edhe në vazhdim midis dy palëve, për studime dhe stërvitje të ndryshme në të ardhmen.



Katërmbëdhjetë efektivë, mes të cilëve katër nga Kosova, përfunduan Kursin e XIII Bazë të Forcave Speciale. Në ceremoninë e organizuar me këtë rast morën pjesë ministrat e Mbrojtjes të Shqipërisë dhe Kosovës, Niko Peleshi dhe Armend Mehaj, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura gjeneralmajor Bajram Begaj, si dhe komandantë të forcave nga Shqipëria e Kosova.

Në fjalën e tij, ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi u shpreh i kënaqur që në këtë kurs morën pjesë edhe efektivë të Forcës së Sigurisë Kosovës: “Ne jemi së bashku për Shqipërinë, për Kosovën, për aleancën tonë në NATO, jemi së bashku për paqen, për sigurinë kombëtare, për mbrojtjen kolektive, jemi së bashku në të gjitha sfidat që na presin. Ne përgatitemi për më të keqen dhe urojmë më të



Katëmbëdhjetë efektivë, mes të cilëve katër nga Kosova,
përfunduan Kursin XIII Bazë të Forcave Speciale

Ministri i Mbrojtjes Peleshi: Ne jemi së bashku për Shqipërinë, për Kosovën, për aleancën tonë në NATO

mirën", - u shpreh Peleshi.

Duke theksuar faktin se pjesëmarrja në FA po bëhet gjithnjë e më motivuese, që nga trajtimet dhe deri te rritja e prestigjit moral të FA-ve, ministri Peleshi u shpreh se: "Shqipëria është dhe do të mbetet një faktor i rëndësishëm

në rajonin e Ballkanit Perëndimor". Lajmi i mirë për gjithë botën është se shqiptarët janë orientuar në kahun e duhur drejt Perëndimit. Ne i shërbejmë këtij orientimi në të gjitha fushat e jetës e veçanërisht në FA, që janë këtu me dinjitetet përkrah Aleancës tonë me

të madhe, politike e ushtarake të NATO-s, përkrah partnerit special strategjik SHBA dhe ju jeni një nga pjesët më të rëndësishme të krenarisë tonë, jeni një nga gurët më të çmuar të kurorës së FA-së", - tha Peleshi.

Ndërsa ministri i Mbrojtjes i Republikës së Kosovës Armend Mehaj, duke iu drejtuar efektivëve të rinj u shpreh se: "Të kalosh këtë sfidë është vetëm fillimi çfarë kërkon atdheu. Si pjesëtarë të Forcës Speciale ju do të jeni të përgatitur për të gjitha sfidat, por edhe kur sfida është aty, ju duhet të jeni të përgatitur të mendoni dhe jashtë kornizave normale dhe ajo të bën më të dalluar nga të tjerët".

Në këtë ceremoni që përkon edhe me rastin e 1 - Vjetorit të krijimit të Regjimentit të Operacioneve Speciale, ministri i Mbrojtjes së Republikës së Kosovës akordoi medaljen "Për shërbime të shquara", për komandantët e Regjimentit të Operacioneve Speciale, batalionit të Forcave Speciale dhe atij Komando, ndërsa ministri i Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë akordoi medaljen "Për shërbime të shquara" për disa prej efektivëve të këtij reparti elitar.

Pjesëmarrësit në ceremoninë e përfundimit të Kursit të XIII Bazë të Forcave Speciale, ndoqën nga afër disa veprime taktike nga stërvitja e përditshme e efektivëve të Regjimentit të Operacioneve Speciale si: luftim i afërt, goditje objekti me depërtim nga toka dhe ajri, qitje ndaj objektivave të lëvizshme, qitje me snajper, veprime alpinistike tek kulla e alpinizmit, etj.

Për ndjekjen e Kursit Bazë të Forcave Speciale, konkurruan 140 ushtarakë të gradave të ndryshme, nga të cilët arritën të fitojnë të drejtën për ndjekjen e tij 59 prej tyre. Megjithatë, vetëm 14 ushtarakë, prej të cilëve 4 nga Kosova, arritën ta përfundojnë me sukses kursin special që zgjat rreth 6 muaj, çka tregon intensitetin dhe vështirësitë fizike ekstreme dhe psikologjike që përmban ky kurs.





Merr detyrën komandanti i ri i Forcës Ajrore

Ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi: I bindur që gjeneral brigade Pulaj do të jetë edhe më pranë problemeve

“Pas pak ditësh fillojmë punimet zyrtarisht në bazën ajrore të Kuçovës”

Gjeneral brigade Ylli Pulaj merr zyrtarisht detyrën e komandantit të Forcës Ajrore të FA-së. Gjeneral brigade Pulajt iu dorëzua flamuri luftarak i Forcës Ajrore nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-së, gjeneralmajor Bajram Begaj në një ceremoni, ku morën pjesë ministri i Mbrojtjes Niko Peleshi e komandantë të forcave.

“Jam i bindur që gjeneral brigade Pulaj me këtë promovim do të punojë edhe më shumë edhe më mirë, do të jetë edhe më pranë problemeve edhe do t’i përballojë me sukses disa sfida që kemi përpara. Duhet të kujtojmë që pas pak ditësh fillojmë punimet zyrtarisht në bazën ajrore të Kuçovës.

Forca jonë Ajrore tashmë do të operojë në një bazë taktike të rëndësishme të aleancës së NATO-s. Pas pothuajse një viti ne do të presim edhe helikopterët Black Hawk, të cilët do të jenë të parët, por jo të fundit në flotën tonë ajrore, e cila po shkon drejt modernizimit, padyshim duke u përballur me sfidën



e vështirë të rritjes së gatishmërisë”, -u shpreh, gjatë fjalës së tij ministri Peleshi, duke shprehur edhe ambicien se deri në fund të vitit FAj do të jetë në gatishmërinë më të lartë që kanë pasur në vitet e fundit. “Do ta pasurojmë, do ta modernizojmë, do të rrisim kapacitetet e brendshme për mirëmbajtjen dhe gatishmërinë por natyrisht do të konsolidojmë dhe një marrëdhënie të re tashmë të

konkretizuar me NATO-n, me Agjencinë e Prokurimit të NATO-s, falë së cilës siç edhe e provuam, kemi një përgjigje shumë të shpejtë në mirëmbajtjen, në riparimin, në shërbimin e flotës sonë ajrore”, -theksoi ministri Peleshi. Gjeneral brigade Ylli Pulaj tha se prioritetet e punës së Forcës Ajrore do të fokusohen në: “rritjen e efikasitetit të përdorimit operacional të mjeteve ajrore; rritjen e kapaciteteve kombëtare të vëzhgimit ajror dhe përmirësimit të shkëmbimit të pamjes ajrore me strukturat përkatëse të NATO-s; rritjen e asistencës profesionale ndaj avionëve luftarakë të NATO-S, gjatë realizimit të misionit të tyre të policimit ajror, në Hapësirën Ajrore të Republikës së Shqipërisë, por edhe rritjen e profesionalizmit gjatë operacioneve, në mbështetje të popullsisë civile dhe autoriteteve shtetërore”.

Gjeneral brigade Ylli Pulaj, gjatë karrierës së tij në Forcat e Armatosura ka shërbyer në detyra të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ndërsa së fundmi mbante detyrën e zëvendëskomandantit të Forcës Ajrore.

Në mjediset e Bazës Ajrore Kuçovë, u zhvillua ceremonia e fillimit të Kursit Bazë të Nënoficerit në specialitetin “Forcë Ajrore”. Në këtë ceremoni mori pjesë komandanti i Forcës Ajrore, gjeneral brigade Ylli Pulaj, shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore kolonel Adrian Kuli, komandanti i Bazës Ajrore Kuçovë major Arqile Olldashi, si dhe instruktorë e kursantë të kursit të sapofiluar. Shefi i Qendrës Stërvitore të Forcës Ajrore në fjalën e hapjes, falënderoi komandantin e Forcës Ajrore për vëmendjen, interesimin dhe kujdesin e vazhdueshëm të treguar gjatë gjithë procesit të arsim-stërvitjes në këtë qendër, si dhe informoi mbi programin, objektivat dhe synimet e këtij kursi. Komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj përshëndeti trupën e kursantëve dhe instruktorëve duke theksuar rëndësinë e kësaj faze arsimimi dhe domosdoshmërinë e të pasurit të nënoficerëve të pajisur me dije teorike, teknike dhe praktike

Gjeneral brigade Ylli Pulaj merr pjesë në ceremoninë e fillimit të Kursit Bazë të Nënoficerit në specialitetin “Forcë Ajrore”



Komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj përshëndeti trupën e kursantëve dhe instruktorëve duke theksuar rëndësinë e kësaj faze arsimimi dhe domosdoshmërinë e të pasurit të nënoficerëve të pajisur me dije teorike, teknike dhe praktike për Forcën Ajrore.

për Forcën Ajrore. Ai shprehu se, pritshmëritë janë të larta dhe se kërkohet angazhim serioz, dëshirë për të mësuar rreth teknikës dhe specifikave të Forcës Ajrore me qëllim përmbushjen e objektivave të përbashkëta.

Gjeneral brigade Pulaj, në përfundim të fjalës përshëndetëse, inkurajoi stafin dhe nënoficerët të

punojnë me optimizëm, përkushtim, përgjegjësi dhe motivim për realizimin e objektivave si dhe uroi për një proces sa më të mbarë kualifikimi e trajnimi në këtë qendër. Kursi Bazë i Nënoficerit të Forcës Ajrore zhvillohet në 8 javë mësimore, arsim-stërvitje dhe praktikë në qendër stërvitore dhe në repartet e Forcës Ajrore.





SHSHP të FA priti atashetë ushtarakë shqiptarë të akredituar jashtë vendit

Gjeneralmajor Begaj: Duhet gjetur rrugë dhe mundësi të cilat i shërbejnë rritjes dhe intensifikimit të marrëdhënieve midis FA

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH gjeneralmajor, Prof. Asoc. Bajram Begaj priti sot në një takim të veçantë atashetë ushtarakë shqiptarë të akredituar jashtë vendit.

Takimi pati në fokus të tij përditësimin nga ana e përfaqësuesve ushtarakë me aktivitetet e tyre, por njëkohësisht edhe informimi mbi arritjet dhe angazhimet e FARSH përgjatë vitit 2021 si dhe projektet dhe objektivat kryesore për vitin 2022.

Gjeneralmajor Begaj, në fjalën e tij, vlerësoi rolin e atashëve ushtarakë jo vetëm si diplomatë në fushën ushtarake, por edhe në funksion të mbështetjes së promovimit të vendit tonë dhe FARSH në përgjithësi. "Duhet gjetur rrugë dhe mundësi të cilat i shërbejnë rritjes dhe intensifikimit të marrëdhënieve midis forcave të armatosura, duke u orientuar në edukimin dhe stërvitjen, bashkëpunimin dypalësh, rritjen e ndërveprimit si dhe projekteve të modernizimit", - theksoi ndër të tjera gjeneralmajor Begaj.

Në fund të takimit, gjeneralmajor Begaj vlerësoi edhe njëherë punën e tyre, duke kërkuar një angazhim maksimal të tyre për vitin 2022, me qëllim thellimin e bashkëpunimit të përbashkët me vendet respektive.



Filloi Kursi i 51-të Bazë i Nënoficerit, QAPN

Filloi në QAPN Kursi 51-të Bazë i Nënoficerit.

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve, për 8 javë radhazi, do të ndjekin kursin e 51-të Bazë, 36 kursantë të ardhur nga struktura të ndryshme të FA-së. Kursi Bazë i Nënoficerit ka si qëllim zhvillimin e elementëve themelorë të personalitetit të Tetarit si drejtues në rol të komandantit të skuadrës dhe detyra të njësuara me të, edukimin dhe përgjegjësinë ndaj detyrës dhe gatishmërisë luftarake, në zbatimin e urdhrave dhe forcimin e disiplinës vetjake.

QAPN ka marrë të gjitha masat organizative e mësimore për të pritur kursantët nga të gjitha repartet e Forcave të Armatosura.

Shkolla e Trupës, Bunavi

19 vite nga krijimi i Brigadës së Stërvitjes Bazë

Kushdo që kalon përgjatë rrugës së Bunavisë, apo vjen në këtë garnizon, është e pamundur të mos dëgjojë këngën që rekrutët e rinj të SIB apo ushtarët e SIA-s këndojnë: "Bijtë e Nënës Shqipëri bëhen bashkë në Bunavi", janë vargjet e para të kësaj kënge sa emocionuese për atë që i dëgjon, po aq frymëzuese për efektivët që i këndojnë. Efektivë që vijnë nga të gjitha krahinat e vendit dhe bëhen bashkë në këtë shkollë të parë të arsimit të tyre ushtarak, vijnë me mendësi dhe temperamente të ndryshme dhe transformohen nga qytetarë, në ushtarë të përgatitur dhe të devotshëm për të shërbyer në Forcat tona të Armatosura.

"Betohen për Flamur, stërviten dhe s'lodhen kurrë", -vijon teksti i kësaj kënge, ku në çdo fjalë të saj, përfshihet gjithë dinamika njerëzore dhe stërvitore në këtë garnizon. Ngarkesa fizike dhe psikologjike, puna me norma dhe standarde, aktiviteti 24-orësh dhe sinjali i borisë janë pjesë e pandarë e procesit gradual transformues. Betimi ushtarak është momenti më solemn në jetën e çdo ushtaraku.

Implementimi i Konceptit të Ri të Arsimimit Ushtarak Profesional në Forcat e Armatosura u shoqërua me ndryshimet e nevojshme organike dhe strukturore, ndryshime që krahas strukturave të tjera në AFA, prekën ndjeshëm edhe Shkollën e Trupës.

Certifikimi i aftësive të personelit të trajnuar në specialitete ushtarake nga Shkolla e Trupës dhe trajnim-kualifikimi i tyre nga qendrat stërvitore të strukturave ushtarake, dikur risi e Konceptit të Arsimimit Ushtarak Profesional, tashmë është kthyer në realitet dhe një përvojë me vlera të

— ■ ■ ■
"Bijtë e Nënës Shqipëri bëhen bashkë në Bunavi", janë vargjet e para të këngës sa emocionuese për atë që i dëgjon, po aq frymëzuese për efektivët që i këndojnë. Efektivë që vijnë nga të gjitha krahinat e vendit dhe bëhen bashkë në këtë shkollë të parë të arsimit të tyre ushtarak, vijnë me mendësi dhe temperamente të ndryshme dhe transformohen nga qytetarë, në ushtarë të përgatitur

■ ■ ■



pakundërshtueshme, e fituar përgjatë testimit, vlerësimit dhe certifikimit të ushtarakëve. Përvoja e fituar në zhvillimin e Stërvitjes Individuale (SIB dhe SIA) është shndërruar në aset me vlerë për Shkollën e Trupës, që tashmë lehtëson realizimin me sukses të padiskutueshëm të kësaj stërvitjeje dhe në përgatitjen e një trupe ushtarësh të devotshëm dhe të aftë për të shërbyer në Forcat e Armatosura.

Stërvitjen individuale të Avancuar e kryejnë vetëm personeli i emëruar për këtë qëllim dhe nuk aktivizohet personel nga kompania e SIB apo strukturat mbështetëse të Shkollës së Trupës, që sigurisht nuk kanë përvojën, nivelin dhe aftësitë e personelit të kompanisë së SIA-s. Në pikëpamje të infrastrukturës jetësore, administrative, stërvitore, mbështetëse dhe mundësive që ofron, Garnizoni i Bunavisë përfaqëson një nga bazat ushtarake më të komple-

tuara dhe më dinjitoze të FA-ve. Me kapacitete të konsiderueshme akomodimi dhe me kushte optimale për zhvillimin e mëtejshëm perspektiv e të qëndrueshëm. Në këtë garnizon ofrohet përvojë e duhur për trajnimin e kursantëve dhe zhvillimin e stërvitjes individuale me ushtarë profesionistë, ofrohen kushtet optimale për zhvillimin e stërvitjes së ushtarit profesionist me regjim 24-orësh dhe sipas standardeve të përcaktuara, duke krijuar mjedisin e duhur për trajtim dhe trajnim të njëjtë për të gjithë trupën e ushtarëve të FA-ve, si dhe garanci të një procesi dhe produktiviteti më cilësor të stërvitjes, pasi kryhet e përqendruar në një strukturë të vetme dhe e specializuar stërvitore.

Fryma e bashkëpunimit të krijuar mes Shkollës së Trupës dhe qendrave stërvitore të njësisë dhe reparteve ushtarake dhe rezultatet

Komandanti i QAPN, kolonel Toska: Arsimimi dhe trajnimi sa më cilësor është esencial

*Metoda bazë e përparimit dhe reformimit social,
duke rritur kështu përfaqësimin dinjitoz në nivelin e
performancës si ushtarakë dhe individë në shoqëri*

Në Qendrën e Arsimit Profesional të Nënoficerëve u zhvillua ceremonia e certifikimit të Kursit 50-të Bazë të Nënoficerit. Në këtë ceremoni morën pjesë Komandanti i QAPN-së, stafi i Komandantit, personel nga Dega e Administratës dhe Arsimit, si dhe stafi instruktorë dhe mësimdhënës.

Gjatë ceremonisë përshëndetën Komandanti i QAPN-së, instruktori përgjegjës i kursit Bazë dhe kursantja e kursit bazë të nënoficerit, e cila përfundoi kursin me rezultate të larta. Në fjalën e tij përshëndetëse për kursantët Komandanti i QAPN-së, Kolonel Arben Toska, ndër të tjera shprehu se "Arsimimi dhe trajnimi juaj sa më cilësor është esencial, pasi është metoda bazë e përparimit dhe reformimit social, duke rritur kështu përfaqësimin dinjitoz në nivelin e performancës si ushtarakë dhe individë në shoqëri. Arsimimi është stafeta e profesionalizmit dhe mbrojtësi më i mirë i lirisë, më i mirë sesa një armatë këmbësorie, ndaj nuk ka investim më të rëndësishëm për ne sesa investimi në arsimim dhe dije". Në këtë ceremoni u certifikuan 59 kursantë.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjeneralmajor Begaj, mori pjesë në takimin virtual të Komitetit Ushtarak të NATO-s, në nivel shefash shtabi, i cili ishte i pari për vitin 2022.

Në hapjen e ditës së parë të takimeve, kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, admiral Bauer vlerësoi rëndësinë e këtij takimi sidomos për ambientin e sigurisë që NATO është duke u përballur.

"Jemi në një moment kyç për sigurinë tonë të përbashkët. Përpara takimit ministror të muajit të ardhshëm dhe Samitit, është parësore që ju, shefat e Mbrojtjes, i dhatë këshilla ushtarake Këshillit të Atlantikut të Veriut për një mori temash, siç janë ato të parandalimit dhe mbrojtjes (Deterrence and Defence), kërkesat e ardhshme në epokën dixhitale, si dhe rritja e bashkëpunimit ushtarak me partnerët. Forca e Aleancës nuk qëndron vetëm në kohezionin dhe vendosmërinë tonë, por edhe në aftësinë për t'u përgatitur së bashku për të ardhmen", -theksoi ai.

Shefat e Mbrojtjes së NATO u angazhuan më pas në diskutime me komandantin suprem të Aleatëve për Transformimin (SACT) gjeneralin Lavigne dhe komandantin suprem të Aleatëve për Europën (SACEUR) gjeneralin Wolters, mbi mundësitë ekzistuese dhe ato të reja për të mundësuar trupat, aftësitë dhe procedurat e NATO të përmbushin tre detyrat e saj kryesore në epokën dixhitale.

Në sesionet e tjera, shefat e Mbrojtjes u fokusuan në Mendimin Strategjik Ushtarak të Aleancës dhe mënyrën se si ai duhet të mbështesë konceptin e ri strategjik të NATO-s, zbatimin e konceptit të NATO-s për luftimin, ecurinë e konceptin për parandalimin dhe mbrojtjen e zonës euro-atlantike, parandalimin dhe qëndrimin e mbrojtjes 360° të NATO-s, si dhe sesionin e dedikuar me partnerët, Ukrainën dhe

Gjeneralmajor Begaj: FA, angazhim maksimal për ndjekjen me interes të situatës në kufirin me Ukrainën

NATO një vëmendje të veçantë duhet të tregojë edhe për çështjet të situatës së sigurisë në krahun jugor të saj, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor

Gjeorgjinë. Gjeneralmajor Begaj në fjalën e tij shprehu falënderimin për SACEUR dhe SACT, duke theksuar mbështetjen e plotë për vlerësimin strategjik gjithëpërfshirës të tyre. Më tej, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA-s shprehu angazhimin për ndjekjen

me interes të situatës në kufirin me Ukrainën, por theksoi se një vëmendje e veçantë NATO duhet të tregojë edhe për çështjet të situatës së sigurisë në krahun jugor të saj, veçanërisht në Ballkanin Perëndimor.

Komiteti Ushtarak është

përgjegjës për këshillimin e autoriteteve politike të NATO-s mbi masat që konsiderohen të nevojshme për parandalimin dhe mbrojtjen e përbashkët të territorit të NATO-s, si dhe për zbatimin e vendimeve në lidhje me operacionet dhe misionet e NATO-s.



Nënkolonel Kuçana: Besoj tek mrekullia që mund të sjellë puna dhe përkushtimi i secilit


Batalioni i II të Këmbësorisë, i Forcës Tokësore (b2kFT) do të drejtohet nga nënkolonel Agim Kuçana. Prezantimi në detyrë i komandantit të b2kFT, u bë nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral brigade Arben Kingji. Fillimisht, fjalën në ceremoni e mori komandanti në largim i b2kFT nënkolonel Dritan Muka, i cili pasi bëri një rezymë të punës dhe sfidave me të cilat u përball efektivi i batalionit, gjatë drejtimit nga ana e tij, falënderoi komandantin e Forcës Tokësore për mbështetjen e pakursyer që i dha repartit, në çdo kohë dhe çdo situatë. Një falënderim të veçantë nënkolonel Muka, adresoi për çdo efektiv të repartit për kontributin dhe angazhimin e tyre.

Ai e mbylli fjalën e tij duke i uruar nënkolonel Kuçanës, suksese në detyrën e komandantit të b2k, duke shprehur njëkohësisht edhe besimin e plotë, se me profesionalizmin që zotëron nënkolonel Kuçana do të arrijë të përballojë me sukses sfidën më të madhe për b2k, siç është certifikimi i Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL).

Nga ana e tij, nënkolonel Kuçana, falënderoi leadershipin politik dhe ushtarak për besimin e treguar me emërimin e tij në detyrën e rëndësishme të komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë. Ai shprehu gjithashtu mirënjohjen për ish-komandantin e b2k nënkolonel Muka, për drejtimin me profesionalizëm të repartit. “Unë besoj tek mrekullia që mund të sjellë puna dhe përkushtimi i secilit



“Drejtimi i batalionit, vjen në një nga fazat më të rëndësishme në historinë e kësaj njësie, atë të certifikimit të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL)”



nga ju, por megjithatë unë besoj tek forca dhe angazhimi i të gjithë grupit, prandaj shpreh bindjen se të gjithë së bashku do ia dalim për të përmbushur këtë angazhim kaq të madh kombëtar siç është certifikimi i GBKL dhe të ngremë më lart emrin e këtij batalioni elitare.” – u shpreh nënkolonel Kuçana.

Në vijim të ceremonisë, pjesëmarrësit u përshëndetën nga komandanti i Forcës Tokësore gjeneral

Kingji, i cili fillimisht shprehu mirënjohjen dhe falënderimet për punën e bërë nga komandanti paraardhës i b2kFT nënkolonel Dritan Muka, në drejtim të këtij reparti të rëndësishëm të FT.

Më tej, duke vlerësuar nënkolonel Kuçanën, si një nga oficerët më me eksperiencë të Forcave të Armatosura, ai shprehu besimin se këtë eksperiencë dhe aftësitë profesionale të akumuluar ndërr



vite prej tij, ai do të dijë t'i verë në dispozicion të rritjes së nivelit të përgatitjes së efektivëve të b2kFT.

"Drejtimi i batalionit, vjen në një nga fazat më të rëndësishme në historinë e kësaj njësie, atë të certifikimit të Grup Batalionit të Këmbësorisë së Lehtë (GBKL), po ashtu në kuadër të ndryshimit në strukturë për t'iu përshtatur kërkesave të certifikimit dhe projekteve në kuadrin e modernizimit në pajisje dhe strukturë. Për këtë arsye, do të kërkoja nga secili nga ju ushtarë, oficerë dhe nënoficerë të b2k, të mbani lart ndjenjën e detyrës dhe të përkushtimit, për të realizuar të gjitha detyrat që rrjedhin nga misioni i b2k, si në kuadër kombëtar po ashtu edhe në detyrimet që kemi në kuadër të Aleancës." , - tha ndër të tjera komandanti i Forcës Tokësore.

Nënkolonel Agim Kuçana, vjen në këtë emërim të ri, pasi kreu me përkushtim dhe devotshmëri detyrën e zëvendëskomandantit të Regjimentit të Operacioneve Speciale (ROS). Ai zotëron një background të admirueshëm si drejtues nënreparti dhe reparti, e ndërthurur kjo me eksperiencën në shtab, nga niveli i batalionit dhe deri në nivelin e oficerit të shtabit në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

NISMA

Forca Ajrore realizon iniciativën për mbjelljen e fidanëve të ullirit në ambientet e jashtme të Garnizonit Rinas

Në Garnizonin Rinas, edhe këtë fillim viti, personeli ushtarak dhe civil i Forcës Ajrore, ka realizuar iniciativën për mbjelljen e fidanëve të ullirit në mjediset e jashtme të Komandës. Me një ceremoni të thjeshtë, në praninë e përfaqësuesve të Shtabit, komandanti i Forcës Ajrore gjeneral brigade Ylli Pulaj, përshëndeti efektivin duke i konsideruar këto nisma të vazhdueshme e të mirëpritura, sidomos për mjediset ku është e domosdoshme më shumë gjelbërim e më shumë oksigjen. Mbjellja e këtyre fidanëve të rinj, theksoi ai, përmban një simbolikë pozitive në këtë fillim viti për të gjithë strukturat e Forcës Ajrore, vit ky, i cili do të shoqërohet me një angazhim serioz në punë dhe plot energji e sfida të cilat do t'i përmbushim të gjithë së bashku.

Gjeneral Pulaj, përfundoi fjalën e tij me urimin për një vit sa më të mbarë në punë e në familje dhe më pas u vijua me mbjelljen e fidanëve të ullirit nga personeli i Komandës dhe Shtabit, Kompanisë së Mbështetjes duke shtuar gjelbërimin dhe treguar kujdesin ndaj mjedisit të punës ku punojmë dhe kontribuojmë përditë. Iniciativa e Forcës Ajrore për mbjelljen e ullinjve të rinj përkon me përkujtimin e 554-vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar Gjergj Kastrioti Skënderbeu, trashëgimi dhe simbolikë kjo qysh nga koha e Skënderbeut.



Basketbollist i ekipit të parë të Partizanit për 20 vjet, me 870 ndeshje në aktivitete kombëtare me 17.900 pikë të shënuara, në 120 ndeshje me 2760 pikë, me 17 kupa republike, pjesëmarrës 20 herë në kampionatet kombëtare

Gazmend Çaçi

Legjenda e basketbollit në panteonin e yjeve të Partizanit

INTERVISTOI:
ANJEZA MUSOLLARI


Intervistë me legjendën e basketbollit Gazmend Çaçi

Gazmend Çaçi, basketbollist i ekipit të parë të Partizanit për 20 vjet, me 870 ndeshje në aktivitete kombëtare me 17.900 pikë të shënuara, në 120 ndeshje me 2760 pikë, me 17 kupa republike, pjesëmarrës 20 herë në kampionatet kombëtare, pjesëmarrës në edicionin e kupës së kampionëve, pjesëmarrës në lojërat olimpike të Barcelonës në vitin 1992, në kampionatin europian, kampionatin ballkanik dhe në lojërat mesdhetare.

Me numrin 11 në fanellën e kuqe, me suksesin e punës së tij, legjenda Gazmend Çaçi vjen në një rrëfim të rrugëtimit disavjeçar për gazetën Ushtria.

Në çfarë moshe ka nisur dëshira për t'u marrë me këtë disiplinë sportive?

Shtëpia ime ndodhej shumë pranë "Shkollës së Bashkuar" dhe unë si një fëmijë kureshtar, qëndroja me orë të tëra pranë kangjellave, tek shihja të stërviteshin në disip-



lina të ndryshme atletë që sot kanë bërë histori. Brenda këtij djaloshi po rritej një dëshirë e madhe për të qenë pjesë e tyre. Fillimisht u mora me atletikë, futboll dhe më pas me basketboll, duke parë që dhe shtat-lartësia ime për moshën që kisha e kalonte normalen. Atë periudhë u afruan trajnerët të cilët më tërhoqën në ekipet e para të rinjve dhe të rinjve. Në moshën 13-14 vjeç u bëra pjesë e ekipit të para të rinjve të Partizanit.

Cila ka qenë ndeshja juaj e parë me ekipin e të rinjve?

Në ndeshjen time të parë me ekipin e të rinjve unë kam qenë rezerva e fundit në ndeshjen Partizani-Tirana, sepse sapo isha bërë pjesë e skuadrës ku Tirana në ato vite ishte kampione e të rinjve dhe ne luanim një finale ku shumë lojtarë të skuadrës tonë po dilnin jashtë me faull. Në këtë moment të vështirë trajneri, me besimin që nuk i mungonte tek unë dhe me kërkesën e tifozëve, më fut në lojë, rezultatin e të cilës e ktheva në favor të Partizanit. Theksoj se koshat i bënë shokët e skuadrës, unë bëra mbrojtjen që solli fitoren. Ky ishte momenti kur trajneri të shprehej se “nga ky moment ky lojtar nuk do dalë më nga fusha e basketbollit”.

Cili është emocioni që përshkon Gaz Çaçin në momentin kur ai fluturon mbi parketin e pallatit të sportit me topin në dorë?

Është një emocion që nuk e përshkruan dot me fjalë, sepse duhet të jesh pjesë e saj dhe ta dashurosh atë që po bën.

Kur e kuptuat përgjegjësinë që ju po luanit me një ekip kampion si partizani?

Këtë e kam kuptuar që në çastin e parë që u bëra pjesë e tij. Mua më ka mbështetur legjenda e sporti Petrit Muzaku, i cili më afroi me ekipin kampion. Por shumë shpejt trajneri i skuadrës gjatë seleksionimeve më nxjerr jashtë dhe unë u riktheva sërish në një admirues të basketbollit nga kangjellat e “Shkolës së Bashkuar” deri kur në vend të këtij trajneri erdhi trajner Muhamet



Përmeti, i cili shikonte admirimin tim gjatë stërvitjes së shokëve dhe më thërret për t'u ribashkuar me skuadrën e zemrës. Trajneri i cili më ka ndjekur që nga para të rinjtë, të rinjtë dhe deri në ekip të parë.

Cila është ajo ndeshje që ju e vlerësoni si historike?

Unë kam shumë ndeshje të mëdha, të kalibrave ndërkombëtare. Kemi luajtur me të gjitha skuadrat që kanë dalë kampion Europe, si Partizani i Beogradit, Bosnja, Banko di Roma, Italia-Skavolini, Skuikamtu, Aris –Selanikut.

Partizani i Beogradit ishte kampion bote, kampion Europe, në këtë kulm të tyre, ne na bie shorti të luajmë me ta dhe dolëm me rezultatin 100 me 97, çka ishte një arritje e madhe për ne, një diferencë kaq e vogël pikësh. Pra ne luanim me këto skuadra si të barabartë. Edhe pse këto merrnin lojtarë të huaj ne ishim me forcat tona. Një triumf i gjithi shqiptar.

Po ndeshja që zhgënjeu pritshmëritë tuaja?

Basketbolli është sport kolektiv dhe ndodh që jo të gjithë janë në formën e tyre më të mirë.

Kemi pasur ndeshje të dobëta si ajo me ekipin kombëtar Italian, dhe kjo si pasojë e çorganizimit tonë. Ishte koha kur në Shqipëri kushtet ekonomike linin për të dëshiruar dhe ne duke humbur në bukuritë e Italisë harruam ndeshjen dhe nuk u përkushtuam si në përballjet e tjera me ta, çka solli dhe fitoren e tyre me një diferencë prej 50 pikësh.

Kush janë trajnerët që punuan për rritjen profesionale të Gazmend Çaçit?

Mirënjohje dhe respekt pa kufi për disa prej trajnerëve të mi, që në fëmijërinë e hershme kur unë kam luajtur në fushat me bar dhe deri tek parketet e pallateve të sportit, si

të nderuarit trajnerë Sami Bushati, Lefi, Njazi Lleshi, Muhamet Përmeti, i cili punoi fort me mua për tre vitet që unë isha me ekipin e të rinjve. Më pas kalova në ekip të parë me trajnerët Qemal Shalsi dhe Astrit Greva.

Cilat janë pikat tuaja më të forta në basketboll?

Bashkëpunimi në grup, marrëdhënia njerëzore, stërvitja, guximi. Vlera që të bëjnë të shkëlqesh në

si duhet, altruizmi, që në të vërtetë janë vlera tek njeriu, por unë vetes ia shoh si dobësi në raport me të tjerët.

Si kanë qenë raportet tuaja me pjesëtarët e tjerë të ekipit?

Ne ishim një familje. Ne gëzonim me njëri-tjetrin, shqetësoheshim për problemet më të vogla të çdo pjesëtarit të ekipit, fitonim, humbim, ishin emocione që i kalonim me njëri-tjetrin, pra siç ndodh në

familjet e vogla ashtu ndodhte dhe tek familja jonë e madhe. 6 muaj në vit ne ishim të grumbulluar, te partizani për takime ndërkombëtare, mbaronim ndeshjet ndërkombëtare me ekipin e Partizanit, grumbulloheshim dhe luanim ndeshjet ndërkombëtare me ekipin kombëtar. Ajo që më bën të ndihem keq është largësia që na ndodhi në fillimet e ndryshimeve politike në Shqipëri. Edhe pse unë kam organizuar aktivitete për t'u bashkuar me miqtë e mi, ka qenë gati e pamundur të bashkoj atë familje të madhe të dikurshme.

Cilët kanë qenë rivalët tuaj në ekipet e tjera me të cilët keni pasur duele të forta por dhe emocionuese?

Ekipi i basketbollit i Shkodrës ka qenë një nga rivalet tanë, sepse në këndvështrimin tim ka qenë një skuadër e fuqishme, por çudia jonë ishte se ne fitonim në Shkodër më lehtë se në Tiranë, me një diferencë prej 10-15 pikësh në favor të Partizanit.

Jo më pak rivalitet kishim dhe me Tiranën, Dinamon.

Ndërsa për ndërkombëtarët do të përmendja skuadrat e Jugosllavisë, të atyre viteve që ishin kampion bote,



një disiplinë sportive si basketbolli.

Po pika juaj më e dobët?

Sentimentalizmi, ndjeshmëria ndaj gjithçkaje që shoh se nuk shkon



skuadrat Italiane, franceze, çeke e cila ishte në vendin e tretë në kampionatin botëror e me të cilët kemi dalë shpesh kampion, siç ishte dhe rasti i përballjes me Greqinë e atyre viteve, kampion bote, ne triumfuam edhe pse në përbërjen e tyre këto skuadra kishin lojtarë të NBA-së.

Çfarë do të thotë të largohesh nga një dashuri e madhe si basketbolli?

Dashuritë nuk braktisen. Unë jam rritur me këtë ndjesi ndaj punova fort për të arritur qëllimin tim në jetë. Sot nuk jam më pjesë e ekipeve por vazhdoj të përçoj tek brezat e rinj dashurinë për basketbollin.

Z. Çaçi, si do e përshkruanit me një fjali basketbollin në kohën e shkëlqimit tuaj, dhe si është ai sot?

Nuk jam me mendimin se atëherë kishte basketboll dhe sot jo, jemi në kohëra të ndryshme, ne atëherë nuk kishim kushtet që kanë sot skuadrat, ne stërviteshim gjithë vitin për një ndeshje ndërkombëtare, ne stërviteshim 7-8 orë në ditë kurse sot maksimumi 2 orë, mungon motivimi, pasioni. Ajo që vë re tek të rinjtë sot, edhe pse me kaq pak angazhim, i kuptojnë gjërat më shpejt sesa ne, por kanë papërgjegjshmëri dhe nuk e dashurojnë atë që bëjnë. Nëse shënon kosh, si shumë idhuj

të kohëve moderne Kobe Bryant apo Stephen Curry, për të rinjtë sot është arritje, por në të vërtetë basketbolli është art, është balet, është përplasje trup me trup, është fantazi pa të cilën basketbollisti nuk mund të arrijë asgjë në këtë disiplinë sportive.

Sot në kampionatin shqiptar po luajnë shumë basketbollistë të huaj, a e shikoni këtë fenomen si pengesë për rritjen e lojtarëve vendas?

Personalisht e shoh si një proces negativ, sepse deri në momentin që merr 2 apo dhe 3 lojtarë të huaj e quajmë pozitive sepse sjell eksperiencë të reja në skuadër, por kur kjo shkon në 8 lojtarë të huaj kjo skuadër nuk është më shqiptare pra kemi humbur identitetin.

A kishit ju një idhull të cilit do të donit t'i ngjanit?

Ka pasur super yje në Europë dhe Amerikë, të cilët i ndiqja me kërshtëri të madhe dhe i adhuroja për spektaklin që jepnin në ndeshjet e tyre. Jam adhures i artit të Kobe Bryant.

Cili është momenti kyç të cilin doni ta veçoni nga karriera juaj?

Një karrierë e gjatë me ulje-ngritjet e veta, me kërkesat e mija ndaj asaj që doja të arrija, shpesh herë më bënte të mos gëzoja re-

zultatet e suksesshme. 25 vite karrierë kanë pasur veçantitë e tyre sepse çdo ndeshje kishte surprizat e saj, por po kujtoj njëherë, eliminatorët e kampionatit europian, ku luanin 7 skuadra europiane dhe unë dola kohëshënuesi më i mirë i asaj eliminatorëve.

Sot përveçse një legjendë në historinë e sportit shqiptar jeni dhe gjysh, po ndikoni që pasardhësit tuaj të ndjekin gjurmët ku denjësisht keni ecur?

Djali im merret me basketboll, në fëmijërinë e tyre dhe dy vajzat e mija, por më pas u larguan për të gjetur veten e tyre aty ku ndihen më mirë. Tani jam gjysh i tre nipërve dhe dy mbesave. Tek të pestë e shoh nga pak veten time, por kjo i mbetet së ardhmes.

Prej vitesh jeni pjesë e strukturave të Forcave të Armatosura si Shef i Sektorit të Aktiviteteve pranë OKMBMMFA, si është të punosh me njerëzit në uniformë?

Unë jam rritur në këto ambiente dhe ruaj një respekt të pakufi për njerëzit që punojnë dhe sakrifikojnë jetën e tyre. Shumë prej sportistëve elite kanë dalë pikërisht prej strukturave të Forcave të Armatosura. Kënaqësi që jam pjesë e tyre në formatin e organizatorit të aktiviteteve sportive.

Nënkolnel (R) ZABIT ÇUKU,
me një karrierë 45-vjeçare në
Armën e Xhenios dhe në FARSH

Ishte 20 janari i vitit 1921, ku me vendimin e qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua Kompania e Parë Xheniere me 150 ushtarë dhe 5 oficerë në përbërje të Divizionit të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Me një mision e detyrë kryesore punimet në infrastrukturë dhe vendosjen e ushtrisë në kazerma dhe kryesisht punime, riparime sipas interesave të situatave dhe të kohës.

Gjergj Kastrioti Skënderbeu si strateg ushtarak përdori me mjeshtëri shumë elementë të sigurimit xhenier të kohës si maskimi, mashtrimi, pritja, hedhjen e gurëve, bllokimin e rrugëve, grykave, hapjen e shkëmbinjve për të marshuar e kaluar trupat e veta, zjarret me prodhimet e baruteve djegëse, tymin, zjarret e të tjerë elementë në pika të dukshme, deri te Gurëhedhësi Shqiptar në ato vite, i cili njihet botërisht edhe në ditët e sotme.

Në vitin 1928 u krijua komanda e parë e trupave xheniere, në vitin 1929 ishin 10 kompani xheniere me detyra sipas nevojave të ushtrisë dhe në interes të komunitetit, por pushtimi fashist më 1939 shkatëroi plotësisht ushtrinë edhe ato pak reparte xheniere.

Në harkun kohor të viteve 1933-1935 kanë vijuar studimet shumë studentë nga Shqipëria në shkollën e Aplikacionit të Artilerisë dhe Xhenios në Torino, duke arritur edhe rezultate të larta, por në ditën e betimit ata tradhtuan flamurin Italian dhe u kthyen në atdheun e tyre Shqipëri duke dhënë kontributin e tyre për çlirimin e vendit nga pushtuesi.

Në Luftën Antifashiste Nacional Çlirimtare, me zgjuarsinë e partizanëve luftëtarë u përdoren shumë elementë të veprimit dhe sigurimit xhenier të luftës me mina e pengesa të tjera. Kështu, më 10 prill 1944, sipas Urdhrit të SHPUNÇ

Në harkun kohor të viteve 1933-1935 kanë vijuar studimet shumë studentë nga Shqipëria në shkollën e Aplikacionit të Artilerisë dhe Xhenios në Torino, duke arritur edhe rezultate të larta, por në ditën e betimit ata tradhtuan flamurin Italian dhe u kthyen në atdheun e tyre Shqipëri duke dhënë kontributin e tyre për çlirimin e vendit nga pushtuesi.



Ishte 20 janari i vitit 1921, ku me vendimin e qeverisë së dalë nga Kongresi i Lushnjës, u krijua Kompania e Parë Xheniere me 150 ushtarë dhe 5 oficerë në përbërje të Divizionit të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

u përgatitën dhe dolën skuadrat e para minatore-zapatore, për të vepruar në mbështetje të veprimeve luftarake të njëjësive partizane, duke arritur fitore deri me ngritjen e barrikadave për çlirimin e Tiranës dhe më pas atdheut, datë e cila mbetet historike pas 20 janarit të

vitit 1921.

Me masat që mori komanda xheniere dhe SHPU, më 26 maj 1945, u krijua, inaugurua reparti i parë xhenier, me emërtimin batalioni Zapator-Minator, në Laprakë.

Drejtor i Komandës së Xhenios



101 VJET ARMA E XHENIOS, 20 JANAR 1921-2022

Gëzuar 101-vjetorin e Armës së Xhenios shqiptare!

ishte Majori Njazi Çepani dhe komandant i batalionit Majori Kadri Ibrahim. Batalioni përbëhej nga dy kompani dhe u vendos menjëherë në plazhin e Durrësit për të kryer çminimin e bregdetit të minuar nga pushtuesit nazifashistë.

Ushtria gjermane në vitet

1943-1944 minoi mbi 400 kilometra gjatësi të bregdetit shqiptar nga Saranda deri në Lumin e Matit, me 100 mijë mina kundërtanqe dhe 200 mijë mina kundër këmbësorisë.

Trupat xheniere, vetëm te shkëmbi Kavajës hoqën nga toka mbi 8 mijë mina kundërtanqe e 2

mijë mina kundër këmbësorisë deri në shtator të vitit 1945.

Në këtë detyrë, këtë mision e aksion shumë të rëndësishëm për sigurinë e jetës së njerëzve dhe zhvillimin e mëtejshëm të ekonomisë së vendit, ranë heroikisht dëshmorit i parë xhenieri kapiten Panajot Hax-

himihali, xhenierët Zenel Skendo, Dilaver Hamzaji, Hazsi Tola, Arif Osmani, Din Shtëmbari, Luftar Cako, e Ytvi Veliu.

Këto çminime kanë vazhduar ndër vite ku aktualisht edhe në ditët e sotme zbulohen mina e municione të ndryshme në territorin e vendit apo në det dhe vetëm nga mendja dhe dora e xhenierëve (EOD) zbulohen e asgjësohen duke shpëtuar jetë njerëzish.

Në gushtin e vitit 1949, në provokacionet grek, trupat xheniere dhe të tjera hapën rreth 20 kilometra transhe, ndërtuan shumë elementë të tjerë, të cilët penguan veprimet sulmuese të ushtrisë Greke.

Për aktivitetet e veprimet e kryera nga trupa xheniere kanë shkruar e folur kolegët e nderuar xhenierë si: Veli Dedi Mendu, Baca, Alfred Moisiu, Ramiz Ficori, Nexhmi Menzelxhi, Abedin Galanxhi, Kosta Panajoti, Miti Golloshi, Thimi Lapi, Bujar Mancellari, Saba Bushi, Abil Zerhani, Besnik Alibali, Lulëzim Salillari, Dedë Prenga, Vasil Premçi etj.

Ndër vite Trupat Xheniere Shqiptare e kanë treguar veten si një domosdoshmëri, një përfaqësuese e denjë e popullit dhe FARSH, me vepra praktike të cilat janë sot histori e gjallë në të katër anët e atdheut.

Nuk ka copë toke, rrugë, mal, fushë, ujë e kodra ku nuk ka punuar dhe kontribuar arma e Xhenios me kuadro ushtarë aktivë e rezervë, të Shqipërisë ndër vite, pavarësisht kush ka qenë në pushtet, detyrat tona kanë qenë dhe janë më se humane në interes të komunitetit.

Nuk ka zona nga Saranda, Përmeti, Himara, Puka, Vlora, Kukësi, Korça, Fieri, Vlora, Durrësi, Shkoda e Burreli, Progonati e Martaneshi, Librazhdi, e Sazani, ku mos të ishin detyrat dhe aktivitetet e përbashkëta të FASH me trupat xheniere dhe njësitë e tjera ushtarake.

Një tregues i punës ishte shumë real në ndihmë të komunitetit për përbalimin e emergjencave civile

si përmbytje dhe detyra të tjera shumë të rëndësishme në planëzim, drejtim e zbatim, ku sot ne jemi krenarë për arritjet dhe nivelin e kuadrove e trupave xheniere.

Rruga e gjatë, e vështirë, me sakrificë, me gjak dhe histori, prej ku në armën e xhenios kemi 5 Heronj të Popullit, nga Xhemal Kada, Veli Dedi, Shyqyri Alimerko, Mendu Baca, Hero i Punës, kemi disa Gjeneralë, me dhjetëra Kolonellë dhe shumë e shumë të tjerë me nivele dhe grada të larta, të cilat i kanë fituar më djersë dhe rezultat konkret.

Kemi me qindra inxhinierë të

dent i Republikës së Shqipërisë dhe sot, më 20 janar 2022, ai gjen rastin për t'ju përshëndetur dhe ju uruar gëzuar dhe suksese të mëtijshme armës së Xhenios Shqiptare.

Trupat xheniere, kryesisht nga vitet 1960-1985, kanë luajtur rolin kryesor në sigurinë e mbrojtjes, si përgatitjen e veprimeve mbrojtëse, ku bazë ka qenë ndërtimi i objekteve fortifikuese, të cilat ishin një domosdoshmëri e pajustifikueshme në periudhën e Luftës së Ftohtë në ato vite.

Sot objektet fortifikuese vlerësohen në radhën e tretë nga



cilët sot po e tregojnë veten për nivelin e tyre drejtues. Nga radhët tona kemi ish-xhenierin e nderuar Dr. Alfred Moisiun, që arriti deri në nivelin Kryetarit të Shtetit, Presi-

studiues të huaj për ndërtimin cilësinë dhe sigurinë e tyre, si PZ, QZ, dhe objektet e mëdha si Gjadri, Porto-Palermo, Kuçova, Shëngjini, Uzinat Ushtarake, strehimet e

popullatës, të drejtim-komandimit e nga vija e parë, të cilat i kanë të gjithë vendet e zhvilluara në Perëndim dhe Lindje edhe në ditët e sotme.

Pas viteve 1990 trupat xheniere, duke përkrahur reformat, kanë kryer me qindra misione për ndihmën e komunitetit nga ujësjellësi Shupenzës në vitin 1994, rruga e Astirit, Bathore, ka riparuar dhe ndërtuar qindra ura e rrugë në gjithë Shqipërinë. Kjo është e do jetë arma e xhenios dhe duhet vlerësuar e respektuar nga secila qeveri ndër vite jashtë politikës.

Në kuadër të PFP, që FA kishin me NATO-n, repartet xheniere dhanë një kontribut të shquar për forcimin e këtyre marrëdhënieve. Në Shqipëri u organizua për herë të parë një stërvitje e përbashkët me xhenieret e ushtrive të shtatë vendeve, e quajtur "Corneston 2001". Suksesi i kësaj stërvitjeje, duke ndërtuar një rrugë të re me gjatësi 4 km, midis dy urave të lumit Mat, i dha një emër të mirë FA-së para aleatëve tanë, sidomos në drejtim të kapaciteteve organizuese e drejtuese. Suksesi i kësaj stërvitjeje të përbashkët, bëri të mundur që të zhvillohen edhe një seri stërvitjesh të tjera "Corneston", në Bullgari e Rumani, ku nënrepartet tona morën pjesë me shumë sukses, jo vetëm me trupa por edhe me mjetet e makineritë tona të ndërtimit.

Pas vitit 1997, për të përbaluar situatën e krijuar në depot e armatim-municionit, hyrjet e të cilave, në mungesë të forcave të mjaftueshme për ruajtjen e sigurinë e tyre, u bllokuan me inerte dhe u minuan me mina anti-personel si dhe veprimet e ushtrisë jugosllave gjatë epopesë së UÇK-së, të cilat hodhën në brendësi të territorit tonë në mënyrë masive mina anti-personel, duke infektuar dhjetëra hektar sipërfaqe, krijuan një situatë të rëndë për jetën e njerëzve dhe për ekonominë e këtyre zonave duke e paralizuar atë.

Për të normalizuar këtë situatë, në bashkëpunim me aleatët tanë të NATO-s, ne krijuam repartin special

të EOD-së, një strukturë që nuk ka qenë më parë në FA-në shqiptare. Përgatitja, kualifikimi dhe certifikimi i tyre u bë nga një ekip ekspertësh me përfaqësues nga ushtritë e shtatë vendeve anëtare të NATO-s. Ky ekip i EOD-së shqiptare përballoi me sukses dhe me profesionalizëm të gjitha hotspotet e krijuara nga hedhja e minave serbe në rajonin e Kukësit e Tropojës si dhe ato të krijuara nga shpërthimet e pakontrolluara të depove të armatim-municionit në të gjithë territorin e vendit, gjatë ngjarjeve të vitit 1997. Sot kjo strukturë vepron me profesionalizëm të lartë në misione jashtë vendit, në mbështetje të njësive të NATO-s dhe përfaqëson me dinjitet xhenion shqiptare.

Në këtë punë të madhe e heroike të njësive e reparteve xheniere, ne duam të kujtojmë me respekt e mirënjohje ata që ranë në krye të detyrës, dëshmorët e armës së xhenios, ata që u përballën me të keqen, në luftë për të shpëtuar jetën e njerëzve të thjeshtë.

Aktet heroike të dëshmorëve të armës së xhenios kanë shërbyer si burim frymëzimi për gjithë brezat e xhenierëve në punën për realizimin e detyrave të vështira për forcimin e fuqisë mbrojtëse të Republikës së Shqipërisë. Mirënjohje pafund për aktin heroik të dëshmorëve të xhenios.

Ne sot kujtojmë me respekt mbi 85 dëshmorë të rënë në krye të detyrës, deri edhe në misione jashtë atdheut, në kuadrin e misioneve e detyrave si anëtarë të denjë të NATOS. Me qindra të plagosur e të gjymtuar nga puna, nga minat e municionet nga viti 1939 e deri te ngjarjet shkatërruese të vitit 1997 apo tragjedia e Gërdecit, më 15 mars 2008.

Punën, veprën, aktivitetin, sakrificat individuale dhe ato familjare i vlerëson populli i respektojnë edhe organizmat e huaja, pasi strukturat e shtetit veçanërisht pas 1990 e kërkojnë kur ka emergjenca, zjarre, përmytje apo tërmete.

Historia e armës së xhenios po merr formë me shkrime e kujtime

të ndryshme ndër vite, në këtë 101-vjetor dhe dëshira individuale e jo institucionale po jep të dhëna për të mbetur e betonuar në themelet e betonta të Shqipërisë.

Sot batalioni i xhenios është i vetmi repart xhenier në Shqipëri i cili nuk njih pushim, festë apo gëzime por gjendet vetëm në gatishmëri për emergjenca në ndihmë të komunitetit veçanërisht pas viti 1990. Në çdo ditë është në operacion për komunitetin dhe janë me qindra ura, rrugë të riparuar e ndërtuara nga këta xhenierë të nderuar.

Ju duhet të ndjeheni krenar, që sot jeni trashëgimtar dhe mbartës të denjë të kësaj historie të madhe e të lavdishme, histori të cilën me siguri do ta pasuronit më shumë me misionin në kuadër të forcave të armatosura, si në kohë lufte e në kohë paqe.

Ne vlerësojmë punën e palodhur të komandantëve që kanë bërë histori në xhenio, si Alfred Moisiu, Josif Zegali, Adem Zyberi, Rexhep Hoxha, Lele Godo, Kastiot Ylli, Ramiz Ficorri, Andon Dhano, Trifon Mihali, Mustafa Dervishi, Nuro Brati, Banush Matuka, Lulëzim Salillari, Islam Batalli, Teodor Demiraqi, Sinan Bunguri, Hajdar Gurra, Beqir Tafili, Arben Mollaj, Përparim Veliu, Petrit Rrama, Andon Dhana e shumë të tjerë.

Në historinë 101-vjeçare nuk njihet asnjë rast, që arma e xhenios të mos i ketë përmbushur me sukses detyrat dhe misionet që i ka vënë atdheu, në kuadër të misionit të FA-së dhe për komunitetin. Ne jemi të sigurt se do ta ngrini më lart flamurin luftarak të armës së xhenios, duke rritur nivelin e përgatitjes tuaj profesionale si dhe kapacitetet teknike e operative të reparteve tuaja.

Me këtë rast ju përgëzoj si pasardhës-veteran, si dashamirës i xhenios dhe të shumë qytetarëve të atdheut edhe për përfaqësimin tuaj në misione jashtë vendit, deri në flijimin e jetës me lavdinë e tyre të pavdekshme.

Lavdi Dëshmorëve të Armës Xhenios!

Shqipëria toka e bekuar!

“Parisi i vogël”, qyteti në juglindje të Shqipërisë

Një qytet
i pasur me
vlëra, tradita,
zakone, pasuri
mbresëlënëse
natyrore, për
të mos lënë pas
dhe kulturën.
Korça mbetet një
ndër qytetet
model në Shqipëri

“**P**arisi i vogël”, qyteti i ser-enatave, djep i kulturës, i shtruar me rrugicat e kalldrëmta. Ka dhjetëra epitete për këtë qytet, për të përshkruar mrekulitë e tij. Një qytet i pasur me vlëra, tradita, zakone, pasuri mbresëlënëse natyrore, për të mos lënë pas dhe kulturën. Korça mbetet një ndër qytetet model në Shqipëri. E ndodhur në juglindje të vendit, ky qytet cilësohet si më i bukuri në vend.

Ndonëse qyteti i Korçës është themeluar në shekujt V-VI, zona e Korçës e ndodhur në truallin historik të ilirëve është banuar që nga mijëvjeçari i katërt p.e.s. Gërmimet kanë nxjerrë në dritë varre dhe fortifikime ilire. Deri në vitin 650 p.e.s. fushëgropa e Korçës udhëhiqej nga një dinasti e Mbretërisë ilire, ndërkohë pas këtij viti u udhëhoq nga një dinasti Kaone. Gjatë kësaj periudhe, zona banohej më së shumti nga fise Kaone dhe Molose. Kra-

hina e Korçës ra nën sundimin e perandorit bullgar Boriz në vitin 853. Ai formoi në këtë zonë njësinë administrative të emërtuar “Kutmicevicë”, që në shqip do të thotë “Tokë e porsa pushtuar”. Forcat bullgare qëndruan këtu deri në vitin 1018.

Në vitin 1440, zona e Korçës u pushtua nga osmanët. Ndërkohë që qyteti modern i Korçës u formua në shekullin XV, kur Iljaz bej Mirahori e zhvilloi Korçën sipas urdhrit të Sulltan Mehmetit II. Nën pushtimin osman, Korça njihej me emrin “Göricë” dhe ishte sanxhak i vilajetit të Manastirit. Por xhamia ishte ndërtimi i parë i Iljaz bej Mirahorit, sepse përreth lulëzoi Pazari i vjetër i Korçës. Qyteti nisi të lulëzojë pas bastisjes së Voskopojës nga osmanët në vitin 1788. Ndërmjet viteve 1769-1789 në Korçë erdhën shumë familje voskopojare, të cilat i dhanë qytetit pak nga lavdia e Voskopojës. Në vitin 1783 qyteti u bë pjesë e Pashallëkut të Ali pashë Tepelenës. Gjatë shekullit



XIX dhe fillim shekullit XX Korça u bë qendër e rëndësishme e Rilindjes Kombëtare. Kështu në vitin 1887 u hap shkolla e parë fillore në gjuhë shqipe nga Organizata Drita, ndërsa po në Korçë, në vitin 1891 u hap shkolla e parë për vajza nga familja Qirjazi. Në vitin 1968 ndërtesa u kthye në Muzeun e Arsimit.

Korça përbën një nga qendrat kulturore më të rëndësishme të Shqipërisë. Vetë muzetë e shumta në qytet përshkruajnë aktivitetin kulturor ndër shekuj. Në këtë qytet është shkolla e parë shqipe, e cila daton në vitin 1887, shkolla e parë në Shqipëri për vajza, si dhe liceu Francez i ndërtuar në vitin 1917. Edhe pse ndër vite qyteti ka qenë pushtuar disa herë, ndikimet e huaja përbëjnë një pjesë të vogël të kulturës korçare.

Korça ka tradita dhe zakone të veçanta, gjë që dëshmon se qyteti ka qenë një vatër e rëndësishme e kulturës me shumëllojshmëri materiale shpirtërore për popullin shqiptar. Dy nga veprat më të rëndësishme të folklorit shqiptar janë "Bleta Shqiptare" e Thimi Mitkos dhe "Valët e Detit" e Spiro Dines.

Çdo qytet dhe krahinë në shekuj ka krijuar kulturën e vet. Kështu dhe populli i Korçës ka krijuar gojëdhëna, përralla, gjëegjëza, këngë, fjalë të urta të njohura në të gjithë vendin. Për to janë kryer studime dhe botime të ndryshme, që janë bërë të njohura e të dashura për shpirtin e shqiptarit dhe të korçarit.


Sa i përket veshjeve tradicionale, fustanellat, kallat dhe opingat me xhufka të zeza, karakterizojnë veshjen e një burri, ku nuk mungonte dhe fesi me ngjyrë të bardhë në kokë. Ndërsa karakteristike për veshjen e grave ishte xhamadani dhe shamia e bardhë në kokë.

I njohur si një nga qytetet më të pasura me monumente kulture, Korça numëron rreth 110 të tillë, të cilët mbrohen nga shteti. Kjo dëshmon se qyteti në të kaluarën ka qenë vatër kryesore e kulturës materiale e shpirtërore. Muzeu i artit mesjetar shqiptar është i vetmi i këtij lloji në Shqipëri. Ai përmban objekte me vlera artistike e shpirtërore që shkojnë deri në periudhën e Mesjetës. Në të ndodhen vepra të piktorëve

të shquar shqiptarë si: Onufri, i biri i tij Nikolla, vëllezërit Athanas Zografi, Kostandin Jeromonaku nga Voskopoja, e shumë të tjerë. Vlen të përmendet këtu Muzeu Arkeologjik i Korçës si dhe Muzeu i Arsimit Korça, përpos serenatave dhe këngëve të dashurisë që janë shpirti i qytetit, të ofron edhe një sërë alternativash për të vizituar.

Eventet e ndryshme apo vizitat në pesë muzetë e qytetit janë një alternativë për ata që preferojnë turizmin kulturor. Katedralja Ringjallja e Krishtit në Korçë është një

trat turistikë me natyrën e tyre piktoreske, ku vlen të përmenden Boboshtica, Dardha apo Voskopoja, ku turizmi familjar dhe temperaturat e freskëta i bëjnë këto fshatra të preferuara. Ndërkohë që sportet dimërore, sidomos skitë, tërheqin turistë të apasionuar pas tyre. Vetëm 20 minuta larg qytetit të Korçës ndodhet Parku Kombëtar i Prespës, një nga parqet natyrore më të mëdhenj dhe impresionues të Shqipërisë që ia vlen të vizitohet, pa lënë mënjane dhe dy liqenet e mrekullueshëm të Prespës së



tjetër atraksion turistik, brenda qytetit. Një katedrale që për nga përmasat cilësohet si më e rëndësishmja në Korçë dhe më e madhja në Shqipëri. Ndërkohë i restauruar vitet e fundit, Pazari i Vjetër i Korçës është bërë qendra e vizitorëve të huaj dhe vendas. Ai mbetet një nga objektet me vlera të hershme historike, kulturore dhe artistike.

Atraksionet turistike me vlera të paçmuara që e pasurojnë edhe më shumë Korçën janë edhe fsha-

Madhe dhe Prespës së Vogël, të cilët prej pesë milion vitesh i bëjnë shoqëri njëri-tjetrit.

Arti i kulinarisë në Korçë është një arsye më shumë për ta vizituar këtë qytet. Gatimi i shpendëve dhe kafshëve të egra është kënaqësi më vete që duhet provuar. Parajsa e juglindjes së Shqipërisë të ofron në të katër stinët e vitit mirazhet e ëndrrave të bukura.

Bukuritë shqiptare, një atraksion që duhet shijuar!

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoan: NATO do të vazhdojë të rrisë mbrojtjen kibernetike të Ukrainës

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm Mircea Geoan mori pjesë virtualisht në eventin Cybersec Global 2022, më 25 janar 2022. Duke u ndalur në tensionet midis Rusisë dhe Ukrainës gjatë fjalimit të tij, Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm theksoi se NATO ka vite që punon me Ukrainën për të rritur mbrojtjen e saj kibernetike dhe do të vazhdojë ta bëjë këtë me ritëm.

Ai tha se: "Përdorimi i sulmeve hibride kundër Ukrainës, duke përfshirë sulmet kibernetike dhe dezinformimin, si dhe grumbullimi i armëve të avancuara në kufijtë e saj, nënvizon rolin kyç të teknologjisë së përparuar në luftën moderne".

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje se Kina dhe Rusia po investojnë shumë dhe po përdorin teknologji të reja me pak respekt për të drejtat e njeriut ose ligjin ndërkombëtar. Ai kujtoi se verën e kaluar aleatët kishin rënë dakord për një politikë të re gjithëpërfshirëse të mbrojtjes kibernetike për NATO-n dhe vazhdoi të thoshte se: "Ne po forcojmë mbrojtjen tonë kibernetike dhe po rrisim qëndrueshmërinë e infrastrukturës tonë kritike dhe zinxhirëve të furnizimit

për të reduktuar dobësitë tona".

Zëvendës Sekretari i Përgjithshëm vuri në dukje gjithashtu rolin udhëheqës të NATO-s në lidhje me teknologjitë e reja, në fusha të tilla si intelijenca artificiale, sistemet autonome, bioteknologjia, të dhënat e mëdha, hipersonikët, llogaritja kuantike dhe hapësira. Ai nënvizoi se: "Për të shmangur çdo boshllëk teknologjik, ne po sigurohemi që inovacioni transatlantik të përfitojë të gjithë aleatët. "Forca e NATO-s vjen nga uniteti i saj dhe aftësia e saj për t'u përshtatur për të mbetur e fortë dhe ruajtja e avantazhit teknologjik është një pjesë e madhe e kësaj", -shtoi ai.

Fjala e Zëvendës Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, Mircea Geoan, në eventin Cybersec Global 2022:

"Jam gjithmonë shumë i lumtur që jam me ju. Unë gjithashtu vlerësoj punën që Izabela po bën për të na ndihmuar në përpjekjet për inovacion të Aleancës përmes Grupit Këshillimor për Teknologjitë në zhvillim dhe përçarës. Kështu që Izabela ju falënderoj që më ftuat dhe ju falënderoj të gjithëve që më keni përsëri, në një edicion të ri të CYBERSEC. Gjithashtu, Instituti Kosciuszko, ju falënderoj shumë për organizimin e kësaj ngjarje shumë të rëndësishme.

Natyrisht, ne të gjithë jemi shumë të fokusuar në tensionet e krijuara nga Rusia në dhe rreth Ukrainës. Rusia, pa provokim dhe as nevojë, ka grumbulluar mbi 100,000 trupa dhe armë të avancuara në kufijtë e Ukrainës.

Edhe pse nuk i dimë me siguri synimet e udhëheqjes në Moskë, potenciali i pushtimit në ditët dhe javët në vijim është real.

Në takimin e Këshillit NATO-Rusi më 12 janar, të gjithë aleatët folën me një zë të vetëm. Ata i bënë thirrje Rusisë që menjëherë të de-përshkallëzojë situatën dhe të respektojë sovranitetin dhe integritetin territorial të fqinjëve të saj. Ata i bënë thirrje Rusisë që t'i japë fund qëndrimit të saj



agresiv dhe të ndalojë aktivitetet e saj keqdashëse që synojnë aleatët dhe partnerët. Sekretari i Përgjithshëm Jens Stoltenberg ka propozuar takime të mëtejshme me Rusinë dhe shumë fusha konkrete ku mund të bëjmë përparim dhe ne jemi të interesuar këtu t'i japim një shans diplomacisë.

Aleatët e NATO-s dhe NATO janë të gatshëm të angazhohen dhe të dëgjojnë shqetësimet e Rusisë, por nuk do të bëjnë kompromis mbi parimet thelbësore: për të drejtën e çdo kombi për të zgjedhur rrugën e tij dhe për aftësinë e NATO-s për të mbrojtur dhe mbrojtur të gjithë aleatët.

Të njëjtat propozime që dalin nga NATO do t'i dalin në ditët në vijim në formë të shkruar Rusisë dhe ne i bëjmë thirrje Rusisë të kthehet në Këshillin NATO-Rusi dhe të diskutojë propozimet që ne po i bëjmë atyre.

Sigurisht, kur bëhet fjalë për kibernetikën, temën e konferencës suaj, ne kemi parë sulmet masive kibernetike kundër institucioneve publike të Ukrainës. Dhe u takon autoriteteve ukrainase të hetojnë dhe t'i atribuojnë atë që ka ndodhur. Por ne të gjithë e dënojmë me gjithë zemër këtë sulm ndaj qeverisë ukrainase.

Në mëngjesin e sulmit, ekspertët kibernetikë të NATO-s në Bruksel ishin menjëherë në kontakt me homologët e tyre ukrainas, duke shkëmbyer informacione dhe duke ofruar ndihmën e tyre. Ekspertët aleatë në vend po mbështesin gjithashtu autoritetet ukrainase në terren. NATO ka vite që punon me Ukrainën për të rritur mbrojtjen e saj kibernetike dhe ne do të vazhdojmë ta bëjmë këtë me ritëm.

Ukraina është një nga partnerët më të ngushtë të NATO-s. Është një marrëdhënie që daton në vitet 1990, kur Ukraina sapo kishte fituar pavarësinë nga Bashkimi Sovjetik. NATO ka punuar ngushtë me Ukrainën për shumë vite për të ndihmuar në reformat dhe për të rritur sigurinë e saj. Në përgjigje të aneksimit të paligjshëm të Krimesë nga Rusia në 2014, ne e forcuar atë marrëdhënie edhe më tej, me më shumë mbështetje për forcat e saj të armatosura dhe për reformën e aparatit të saj të sigurisë. NATO i ka ofruar Ukrainës fonde mirëbesimi, trajnime dhe stërvitje, si dhe ndërgjegjësim për situatën. Ne kemi rritur praninë tonë në Detin e Zi dhe Ukraina është tani një partner i mundësive të zgjeruara, duke na sjellë më afër se kurrë.

Ne po punojmë që Ukraina të ketë akses në platformën e shkëmbimit të informacionit të malware të NATO-s, për të ndihmuar në rritjen e mbrojtjes kibernetike të Kievit. Ukraina është gjithashtu përfituesi i vetëm më i madh i programit tonë Shkencë për Paqe dhe Siguri, me 26 projekte në zhvillim e sipër që mbulojnë një gamë të gjerë teknologjish të avancuara. Një projekt i tillë quhet DEXTER - një mjet për zbulimin e armëve të zjarrit dhe eksplozivëve në hapësira publike si aeroportet dhe stacionet e trenave. Kjo masë kundër terrorizmit po

përmirëson drejtpërdrejt sigurinë e popullit të Ukrainës.

Javën e kaluar, Agjencia e Komunikimit dhe Informacionit e NATO-s, NCIA, nënshkroi një marrëveshje me Ukrainën që e rriti edhe më tej bashkëpunimin tonë. Ai do të thellojë bashkëpunimin tonë dhe do të modernizojë më tej IT-në dhe komunikimet e tyre dhe do të identifikojë fushat për trajnime të mëtejshme. Mbështetja e fortë politike dhe praktike e NATO-s për Ukrainën do të



vazhdojë në javët, muajt dhe vitet në vijim.

Por ne gjithashtu duhet të jemi të vetëdijshëm për sfidat e teknologjisë. Dhe përdorimi i sulmeve hibride kundër Ukrainës, duke përfshirë sulmet kibernetike dhe dezinformimin, si dhe grumbullimi i armëve të avancuara në kufijtë e saj, nënvizon rolin kyç të teknologjisë së përparuar në luftën moderne.

Fuqia e fortë ushtarake do të jetë gjithmonë shtylla kurriore e parandalimit dhe mbrojtjes sonë, por ne gjithashtu e dimë se tanket, anijet dhe avionët, sado të avancuar, tani janë vetëm një pjesë e ekuacionit.

Teknologjitë e avancuara përçarëse po ndryshojnë peizazhin tonë të sigurisë, me inteligjencën artificiale dhe të dhënat e mëdha që udhëheqin rrugën. Përparimet në bioteknologji, sisteme autonome dhe informatikë kuantike, kanë të gjitha potencialin për të sjellë përfitime të mëdha për shoqëritë tona, por ato paraqesin gjithashtu një kërcënim real dhe të rëndësishëm për sigurinë tonë.

Vitin e fundit, ne kemi parë teste të suksesshme të raketave hipersonike nga Kina, Rusia dhe madje edhe Koreja e Veriut. Raketat që mund të fluturojnë me shpejtësi të jashtëzakonshme, të shmangin mbrojtjen konvencionale të raketave dhe potencialisht të dëgjojnë një kokë bërthamore në çdo pikë të planetit brenda pak minutash.

Kina dhe Rusia po investojnë shumë dhe po përdorin teknologji të reja me pak respekt për të drejtat e njeriut apo ligjin ndërkombëtar, duke sfiduar në mënyrë agresive avantazhin tonë teknologjik. Dhe ndërsa më shumë nga shoqëritë tona dhe ushtritë tona varen nga një kornizë dixhitale, ne bëhemi më të ndërlidhur, por edhe më të cenueshëm. Pra, është edhe më jetike që ne të gjithë

të bëjmë gjithçka në fuqinë tonë për të siguruar rrjetet tona dhe infrastrukturën dixhitale.

Sulmi ndaj kompanisë amerikane të IT-së, "Solar-Winds" është një rast i tillë. Ajo ekspozoi informacione të ndjeshme dhe çoi në futjen e dyerve të pasme në një numër të madh kompanish dhe agjencish qeveritare në mbarë botën.

Kjo është arsyeja pse NATO po përshtatet. NATO dhe aleatët tanë po i përgjigjen kësaj vale të avancimit teknologjik për të siguruar sigurinë tonë të vazhdueshme dhe avantazhin tonë teknologjik. Së pari në kibernetikë. Verën e kaluar, aleatët ranë dakord për një politikë të re gjithëpërfshirëse të mbrojtjes kibernetike për NATO-n. Ajo pranon se hapësira kibernetike është e kontestuar në çdo kohë. Mund të ketë sulme kibernetike që ndodhin pikërisht në këtë moment. Ndryshe nga domenet e tjera, kibernetika është gjithmonë aktive. Pra, ne duhet të jemi gjithmonë të gatshëm për të penguar, mbrojtur dhe luftuar në mënyrë aktive të gjitha kërcënimet dhe aktorët. NATO e ka njohur hapësirën kibernetike si një fushë operacionesh dhe një sulm kibernetike, tani mund të jetë bazë për të thirrur nenin 5 të Traktatit Themelues të NATO-s.

Ne kemi një qendër të re të operacioneve kibernetike në Mons, këtu në Belgjikë. Ajo siguron ndërgjegjësimin e situatës për komandantët ushtarakë, për të informuar dhe mbështetur operacionet dhe misionet. Ajo gjithashtu koordinon aktivitetin operacional të NATO-s në hapësirën kibernetike, duke siguruar lininë për të vepruar dhe duke i bërë operacionet tona më elastike ndaj kërcënimeve kibernetike.

Në fund të vitit të kaluar, Manfred Boudreaux-Dehmer u bë Zyrtari i parë Kryesor i Informacionit i NATO-s, me përgjegjësi për sigurimin e kohezionit në të gjithë Aleancën kur bëhet fjalë për TIK-un dhe sigurinë kibernetike.

Në vitin 2016, në Samitin e Varshavës, liderët e NATO-s miratuan Betimin e Mbrojtjes Kibernetike. Që atëherë, aleatët kanë ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të forcuar aftësitë e tyre kibernetike, për të përmirësuar kuadrin e tyre ligjor dhe institucional dhe për të rritur burimet e dedikuara për përbalimin e kërcënimeve kibernetike.

Për t'ju dhënë disa shembuj, në Shtetet e Bashkuara më shumë se 1.6 miliardë e planit të rikuperimit të COVID-it është caktuar për infrastrukturën kritike të IT-së dhe sigurinë kombëtare kibernetike. Akti i fundit i Gjermanisë për Sigurinë 2.0 e IT-së pasqyron rëndësinë në rritje të kibernetikës.

Rezistenca dhe aftësitë kibernetike janë thelbësore për Rishikimin e Integruar të Mbretërisë së Bashkuar të politikës së saj të jashtme dhe të mbrojtjes.

Dhe nga Luksemburgu në Sllovaki, deri në Turqi, kombet po rrisin masat legjislative dhe praktike për të rritur qëndrueshmërinë tonë kolektive. Ne po forcojmë mbrojtjen tonë kibernetike dhe po rrisim qëndrueshmërinë e infrastrukturës tonë kritike dhe zinxhirëve të furnizimit për të reduktuar dobësitë tona.

Përtej kibernetikës, NATO po kryeson gjithashtu rrugën kur bëhet fjalë për teknologjitë e reja. Në vitin

2019, në Londër, udhëheqësit tanë miratuan një udhërrëfyes gjithëpërfshirës mbi teknologjitë në zhvillim dhe përçarës, duke u fokusuar në ato që do të kenë ndikimin më të madh në sigurinë tonë. Inteligjenca artificiale, sistemet autonome, bioteknologjia, të dhënat e mëdha, hipersonikët, llogaritja kuantike dhe hapësira, e cila tashmë konsiderohet vetë një fushë operacionesh për NATO-n.

Ne po sigurohemi gjithashtu që inovacioni transatlantik të përfitojë të gjithë aleatët dhe ndërveprueshmëria do të vazhdojë të jetë shtylla kurrizore e Aleancës sonë.

Si një Aleancë prej 30 vendesh, me ekonomi të ndryshme dhe ekosisteme inovative, është jetike që ne të mund të punojmë së bashku dhe të mbrojmë njëri-tjetrin në një krizë dhe të shmangim çdo boshllëk teknologjik.

Kjo është një nga arsyet kryesore pse ne lançuam Përsheptuesin e Inovacionit të Mbrojtjes për Atlantikun e Veriut, ose "DIANA", në Samitin e Brukselit qershorin e kaluar, për të krijuar një tubacion inovacioni që përfshin Atlantikun. Nëpërmjet "DIANA"-s ne do të punojmë edhe më ngushtë së bashku me industrinë, me bizneset fillestare dhe akademinë, për të identifikuar dhe zhvilluar gjeneratën e ardhshme të teknologjive për të përmbushur nevojat tona të mbrojtjes dhe sigurisë.

Ne po krijojmë gjithashtu një Fond shumëkombësh të Inovacionit të NATO-s për të siguruar fonde të sigurta për bizneset fillestare që zhvillojnë teknologji të avancuara me përdorim të dyfishtë. Ne synojmë që të dyja këto iniciativa t'i kemi në funksion deri në Samitin tonë të ardhshëm të NATO-s në Madrid në fund të qershorit.

Zonja dhe zotërinj, ne qëndrojmë në një udhëkryq. Ne përballemi me perspektivën reale të luftës në Evropë për herë të parë në shumë e shumë dekada. Është dëshira jonë e sinqertë që diplomacia dhe dialogu të shmangin perspektivën e konfliktit dhe dhunës.

Kostoja për Rusinë e një tjetër inkursioni në Ukrainë do të jetë tepër e lartë. Do të pasojnë sanksione të ashpra ekonomike dhe politike. NATO dhe aleatët e NATO-s qëndrojnë me Ukrainën. Forca e NATO-s vjen nga uniteti ynë dhe nga aftësia jonë për t'u përshtatur, për të mbetur të fortë dhe për të ruajtur parandalimin dhe mbrojtjen tonë. Ruajtja e avantazhit tonë teknologjik është një pjesë e madhe e kësaj.

Këtu, dhe këtë e kam thënë shumë herë, ne kemi një avantazh të qartë ndaj konkurrentëve tanë: shoqëritë tona të lira dhe të hapura. Ne kemi mendjet më të ndritura, universitetet më të mira dhe kompanitë më inovative. Populli ynë mund të mendojë lirisht dhe të veprojë lirisht. Dhe për ne, të ardhur nga Europa ish-komuniste, ne e dimë këtë më mirë se kushdo tjetër. Është mënyra më e mirë për të nxitur inovacionin emocionues që do të sigurojë sigurinë dhe lirinë tonë për shumë dekada në vijim.

Dhe ky është thelbi i misionit të NATO-s dhe teknologjive që do të ndihmojnë në mbrojtjen e vlerave tona që i mbajmë kaq të shtrenjta. Pra, e dashur Izabela, të dashur miq, faleminderit shumë që më keni pritur dhe shpresoj se vitin e ardhshëm do të jemi në gjendje të takohemi personalisht. Faleminderit dhe ju uroj suksese në vazhdim të punës suaj.

Takimi i Shefave të Mbrojtjes të NATO-s

Shefat ushtarakë të NATO-s diskutojnë mbrojtjen euro-atlantike

Admirali Bauer: Jemi në një moment kyç për sigurinë tonë të përbashkët

Më 12 dhe 13 janar 2022, 30 shefat e Mbrojtjes së aleatëve zhvilluan takimin e parë të planifikuar në këtë format. Dita e parë e sesioneve u fokusua në Mendimin Strategjik Ushtarak si dhe kërkesat dhe aftësitë ushtarake. Në hapjen e ditës së parë të takimeve, Kryetari i Komitetit Ushtarak të NATO-s, Admirali Bauer priti të 30 shefat e Mbrojtjes në takimin e parë në këtë format të vitit 2022. "Jemi në një moment kyç për sigurinë tonë të përbashkët. Përpara takimit ministror të muajit të ardhshëm dhe samitit të ardhshëm, është parësore që ju, shefat e mbrojtjes i dhatë këshilla të pakufizuara ushtarake Këshillit të Atlantikut të Veriut për një mori temash, duke filluar nga Parandalimi dhe Qëndrimi ynë aktual i Mbrojtjes, deri te kërkesat tona të ardhshme në epoka dixhitale, si dhe rritja e bashkëpunimit tonë ushtarak me Partnerët. Forca jonë si Aleancë nuk qëndron vetëm në kohezionin dhe vendosmërinë tonë, por edhe në aftësinë tonë për t'u përgatitur së bashku për të ardhmen dhe të papriturën", -theksoi ai.

Në konferencën për shtyp pas seancës së Komitetit Ushtarak me 30 Shefat e Mbrojtjes, Admirali Rob Bauer, Kryetar i Komitetit Ushtarak të NATO-s njoftoi se do të mbahen edhe dy konferenca të tjera këtë vit, në maj dhe shtator. Këto takime ofrojnë një mundësi që Autoriteti më i Lartë Ushtarak i NATO-s të bashkohet, për të vlerësuar situatën aktuale të sigurisë, për të diskutuar çështjet e vazhdueshme të punës dhe për të reflektuar mbi kërkesat e ardhshme. Për gati 73 vjet, NATO ka mbetur Aleanca më e fortë ushtarake në botë përmes aftësisë së saj për t'u përshtatur, për të pritur të papriturën dhe për



t'u përgatitur për të. Në klimën e sotme të sigurisë, NATO po përballët me grupin më kompleks të sfidave në një brez; Rusia është më agresive jashtë vendit dhe më shtypëse brenda.", -tha ai. Shefat e Mbrojtjes të NATO-s u angazhuan më pas në diskutime me Komandantin Suprem të Aleatëve për Transformimin, gjeneralin Lavigne dhe Komandantin Suprem të Aleatëve për Europën, gjeneralin Wolters, mbi mundësitë ekzistuese dhe potenciale të reja për të mundësuar trupat, aftësitë dhe procedurat e NATO-s të përmbushin tre detyrat e saj kryesore në fushën epokës dixhitale. "Në NATO, ne jemi shumë të vetëdijshëm për sfidat dhe mundësitë që ofron epoka dixhitale dhe jemi të angazhuar në mënyrë aktive në një transformim dixhital të mënyrave tona të punës, pajisjeve

tona dhe burimeve tona njerëzore. Tani duhet t'i përkthejmë këto mundësi në procese aktuale që do të na mundësojnë të mbështesim më mirë komandantët tanë në det, në tokë, në ajër dhe ata që punojnë në fushën kibernetike dhe hapësinore", -sqaroi Admirali Bauer.

Në sesionin e fundit të ditës, Shefat e Mbrojtjes së Aleatëve u fokusuan në Mendimin Strategjik Ushtarak të Aleancës dhe mënyrën se si ai duhet të ushqehet me Konceptin e ri Strategjik të NATO-s. Ata u informuan gjithashtu mbi zbatimin e Konceptit të NATO-s për Kapitullin Luftimi, si dhe përparimin në Konceptin për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Zonës Euro-Atlantike.

Kurse më 13 janar 2022, shefat e mbrojtjes së NATO-s filluan ditën e dytë të takimeve me një dialog me Sekretarin e Përgjithshëm të NATO-s, Jens Stoltenberg, i cili parashtrroi prioritetet dhe perspektivat e tij për situatën e sigurisë. Sesioni tjetër i ditës u fokusua në mjedisin aktual të sigurisë globale dhe qëndrimin e vazhdueshëm të parandalimit dhe mbrojtjes të NATO-s.

Shefat e Mbrojtjes u takuan gjithashtu me partnerin e tyre ukrainas, gjenerallejtënant Zaluzhnyi, i cili i informoi ata mbi situatën aktuale të sigurisë në dhe rreth vendit të tij, si dhe zhvillimet në reformat e tyre të vazhdueshme të mbrojtjes. Më vonë, partneri i tyre gjeorgjian, gjeneralmajor Matiashvili shpjegoi reformat dhe aftësitë e reja mbrojtëse të zhvilluara përmes Paketës Substanciale NATO-Gjeorgji. Kjo ishte hera e parë që Komiteti Ushtarak u takua në Sesionin e Shefave të Mbrojtjes për vitin 2022. Ndërkohë ka një takim të dytë të planifikuar në maj në selinë e NATO-s në Bruksel dhe një tjetër më vonë këtë vit në një shtet anëtar aleat.



Kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, i shoqëruar nga ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj, zëvendësministri Shensi Sylja dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi, në përvjetorin e 38-të të rënies së heronjve, Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, vizituan Regjimentin e parë të Forcave Tokësore të Forcës së Sigurisë së Kosovës, në Kazermën "New Born", në Gjilan.

Në fjalimin para pjesëtarëve të Regjimentit, kryeministri Kurti u shpreh i nderuar dhe krenar për vizitën dhe shtoi se nuk ka mënyrë më të mirë për të filluar vitin e ri.

Kryeministri Kurti theksoi se ngritja e ushtrisë është detyrë e përbashkët dhe se Qeveria e Republikës së Kosovës e merr me shumë përkushtim modernizimin e ushtrisë si me pajisje dhe me armatim, ashtu edhe kushtet e shërbimit, si dhe me ofrimin e mundësive ku ushtarët mund t'i tregojnë shkathtësitë e tyre.

Më tej, ai tha se këmbësoria, si degë më e vjetër e ushtrisë, dëshmon që teknologjia dhe pajisjet ushtarake, sado të sofistikuara dhe precize, nuk mund ta zëvendësojnë vrullin dhe fuqinë e luftarakut të zot.

"Në vitin që lamë pas,



Kryeministri Kurti dhe ministri Mehaj vizituan Regjimentin e parë të Forcave Tokësore të FSK-së

"Profesionalizëm dhe përkushtim në shërbim të paqes e sigurisë"

FSK-ja tregoi profesionalizëm të lartë, përkushtim në shërbim të paqes e sigurisë, jo vetëm brenda kufijve të saj, por edhe jashtë, si dhe, jo vetëm për qytetarët e saj, por edhe të gjithë ata që kanë nevojë", tha kryeministri Kurti.

Gjatë fjalimit të tij, ai theksoi si një ndër sukseset më të larta të vitit 2021, pjesëmarrjen në "Defender Europe '21", ku u tregua gatishmëria, profesionalizmi dhe ndërveprimi me ushtarakët e NATO-s dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

"Pjesëmarrja në ushtrimin ndërkombëtar mjaft i suksesshëm

i kompanisë tuaj, është testament i arritjeve, të cilët na bëni çdo ditë krenarë të gjithë neve", -tha kryeministri Kurti. Ai shprehu bindjen se sfida e radhës, "Defender Europe '23", do t'i gjejë edhe më mirë, edhe më të përgatitur. Në të njëjtën ditë, me rastin e 38-vjetorit të rënies së dëshmorëve Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha, ministri Mehaj, në shoqërim të zëvendësministrit Sylja dhe stafit të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes, vizituan familjet e tyre në Gjilan. Ata gjithashtu bënë homazhe në varrezat e dëshmorëve të komunës së Gjilanit.

Komisioni për Siguri Kombëtare i Kuvendit të Shqipërisë vizitoi Ministrinë e Mbrojtjes dhe SHP të FSK-së

Në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së sot ishin për vizitë, deputetët, anëtarë të Komisionit për Siguri Kombëtare, të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kryesuar nga z. Nasip Naço. Në fillim ata u pritën dhe u shoqëruan nga zëvendësministri i Mbrojtjes, Shemsi Syla dhe zëvendëskomandanti i FSK-së, gjeneralmajor Enver Cikaqi. Më pas në takim të veçantë, deputetët, të shoqëruar edhe nga kolegët e tyre nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, kryesuar nga zëvendës kryesuesi, deputeti Enver Dugolli, u pritën edhe nga Ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj. Nga të dyja palët u vlerësua shumë lart bashkëpunimi ndërinstitucional dhe shkëmbimi i eksperiencave edhe në nivele të tilla, si vlerë e shtuar e marrëdhënieve të ngushta vëllazërore.

Gjithashtu, të gjithë ishin



të një qëndrimi se, mbikëqyrja parlamentare është instrumenti i fuqishëm i kontrollit demokratik të forcave të dy vendeve tona, si forca moderne me përcaktim dhe doktrinë me bazë në vlerat e qarta euroatlantike. Vizita vazhdoi më pas

edhe në Shtabin e Përgjithshëm të FSK-së, ku u pritën dhe u informuan nga shefi i stafit, gjeneral brigade Jeton Dreshaj, duke përfunduar me vizitën në Qendrën e FSK-së për Studime Universitare "Wesley Clark".

KOSOVA KA PËRPARUAR NË LUFTËN KUNDËR KORRUPSIONIT

Presidentja e Kosovës, Osmani: Vendi është duke ecur hap pas hapi drejt "çrrënjësjes së korrupsionit"

Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka deklaruar se Kosova ka përparuar në luftën kundër korrupsionit, bazuar në indeksin e perceptimit të hartuar nga "Transparency International".

Osmani ka reaguar pas këtij rezultati, ku Kosova shënoi rritje prej 17 pozitave në publikimin e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021, duke e cilësuar këtë si ngritjen më të lartë vjetore për Kosovën në historinë e publikimit të Indeksit. Osmani tha se kjo tregon

se vendi është duke ecur hap pas hapi drejt "çrrënjësjes së korrupsionit". "Para një viti premtuam që luftimi i korrupsionit do të ishte një prej prioriteteve kryesore të institucioneve të reja. Sot, ky premtim po sheh rezultatet e para jashtëzakonisht premtuese. Gjatë vitit që lamë pas, Republika e Kosovës shënoi rritje prej 17 pozitave në publikimin e Indeksit të Perceptimit të Korrupsionit për vitin 2021 të "Transparency International",

ngritja më e lartë vjetore për Kosovën në historinë e publikimit të Indeksit. Hap pas hapi, drejt çrrënjësjes së korrupsionit", -ka shkruar Osmani. Këtë rezultat e kanë përshëndetur edhe ambasadat e Gjermanisë, Francës dhe Britanisë, të cilat janë shprehur të lumtura për këtë përparim të Kosovës në luftën kundër korrupsionit. Sipas këtij raporti, vetëm Mali i Zi qëndron më mirë në Ballkanin Perëndimor, me 46 pikë.



Secila kohë i ka heronjtë e vet dhe secili popull u falet atyre. Heronjtë janë njerëz të zakonshëm që dëshmojnë trimëri e maturi të jashtëzakonshme në periudha të rënduara, të pasigurta e kërcënuese. Ata nuk bëjnë përlogaritje e kalkulime por zgjedhin të luftojnë për idealin më të lartë dhe mbi çdo interes personal.

Ata nuk krijohen rastësisht, ngase rruga që zgjedhin nuk është e rastësishme. Rruga e tyre ka qëllim, e qëllimi është kauza.

Të tillë ishin Jusuf e Bardhosh Gërvalla dhe Kadri Zeka.


Dyzetë vjet më parë, aktiviteti patriotik i tyre u ndal dhunshëm në një atentat në Untergruppenbah të Gjermanisë, por ata inspiruan shumë të tjerë pas tyre, e vazhdojnë të inspirojnë edhe sot.

Të tre heronjtë tanë u vranë nga UDB-ja e Serbisë, e kësaj u pre rruga një uragani përbashkues, treshes e cila brengën për atdheun e mori me vete.

Sot ndihem krenarë që jam para jush në këtë përvjetor kujtimi për këta heronj që idenë e lirisë dhe të shtetit e kishin projektuar qëmoti.

Sot përkulemi para tyre dhe jemi falënderues që kauza e tyre sot është realitet.

Jemi krenar për këtë brez të heronjve, kauza e të cilëve vazhdoi ndër breza dhe u



40 vjet nga vrasja e Jusuf e Bardhosh Gërvallës dhe Kadri Zekës

Presidentja Osmani: Secila kohë i ka heronjtë e vet dhe secili popull u falet atyre

kurorëzua me shtetin e pavarur, me Republikën tonë më 17 shkurt 2008.

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu ishin kalitur me idenë e Kosovës Republikë. Prandaj, më 1981, Jusufi fliste qartë për realizimin e saj.

"Populli është i pagabueshëm", -thoshte ai. "Unë, ti, ai tjetri edhe mund të gabojmë, kurse populli që

po tregohet kaq i durueshëm për realizimin e kërkesës që Kosovës t'i njihet statusi i Republikës, pa kurrfarë dyshimi se do të dijë se deri ku shtrihen kufijtë e durimit për fitimin e statusit të Republikës", -kishte deklaruar në njërin nga fjalimet e tij.

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu mbesin njerëz të sakrificës, rezistencës dhe vizionit për të ardhmen e atd-

heut që shumë e deshën.

Duke kombinuar aktivitetin e tyre patriotik edhe me atë kulturor në rastin e Jusufit, ata u bënë referencë e kohës për angazhimin, përkushtimin dhe këmbënguljen për idenë e Kosovës shtet.

"Puna dhe vepra e tyre na e lanë lirinë e cila na duhet si buka dhe fryma e Zotit, e këtë diti ta bëjë Jusuf Gërvalla. Ata trasuan rrugën e lirisë, ndërkaq krenaria për ta e shembulli i tyre do të përcillet ndër breza", -kishte thënë presidenti historik, Dr. Ibrahim Rugova kur eshtrat e heronjve u sollën në Kosovë.

Prandaj, Jusufi, Bardhoshi e Kadriu janë konsistentë dhe ju kanë mbijetuar shumë situatave dhe shumë zhvillimeve.

Jo rastësisht, heronjtë tanë kishin kombinuar në mënyrë perfekte aktivitetin kulturor me atë patriotik.

Si patriotë, ata e kishin të qartë se liria nuk është koncept vetëm individual, prandaj më tërë qenien e tyre u përpoqën gjatë gjithë viteve të veprimtarisë ta përmbushin synimin për liri kombëtare, për të cilën nuk ka çmim, dhe për të cilën paguan me çmimin e jetës.

Në një letërkëmbim me shokët e burgut, Jusufi dëshmon se besimin në lirinë e kishin që të tre të përbrendësuar, prandaj edhe ai nuk hezitonte asnjëherë që ta shpërfaqte.

"E ardhmja është e jona. Liria po vjen...", -thoshte ai.

Sot teksa kujtojmë Jusufin, Bardhoshin e Kadriun, kemi mundësinë të reflektojmë për rrugën e zorshme, të cilën e ka kaluar populli ynë deri në bërjen e shtetit.

Kjo rrugë ishte e mundimshme,

por edhe e lavdishme. Këta njerëz janë kryengritës, heronj, por edhe frymëzues, kauza e të cilëve ishte e qartë, pra krijimi i shtetit tonë.

Fati i Jusufit, Bardhoshit e Kadriut është i bashkëdyzuar me atë të Kosovës. Ata u detyruan ta braktisin Kosovën, porse duke pasur në mendje gjithnjë vendin, të cilit i mungonte liria.

Këtë vit ne kujtojmë 40-vjetorin e vrasjes së tyre, uraganin patriotik e kulturor të të cilëve e ndërpreu atentati, duke lënë pas emra domethënës, kuptimi i të cilëve mbushet në çdo përvjetor.

Ndoshta të tre heronjtë nuk e



kanë imagjinuar kurrë se do të iknin prej kësaj bote në ditën e vdekjes së heroit kombëtar Gjergj Kastriotit, i cili ishte frymëzim i pandalshëm i tyre, por edhe i yni.

Vrasja e Jusufit, Bardhoshit e Kadriut ishte goditje e madhe për aktivitetin edhe të mërgatës sonë, e cila që prej asaj kohe nuk ka ndaluar asnjë çast që t'i shërbejë atdheut në të gjitha mënyrat e mundshme.

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu janë dëshmi e kontributit të çmuar që ka dhënë kjo mërgatë për shtetin tonë.

Të tre heronjtë u shuan me mallin për Kosovën. Jusufi në një letër drejtuar nënës Ajshe, më 1980, citonte fjalët e saj që ua kishte thënë qysh në fëmijëri: Rruga e nderës asht ma e zorshmja, po ma e mira dhe e vetmja rrugë e vërtetë për njeriun. Kush u mundue për nder, nder ka gjetë!"

Jusufi, Bardhoshi e Kadriu ecën pikërisht në këtë rrugë, rrugën e nderës, e zorshme, por edhe e kollajshme, e kollajshme sepse ata gjithsecili i qëndruan besnik nderit.

E në letrën e tij, ai e inkurajon nënën Ajshe, që mos të dorëzohet.

"Ma në fund, thotë ai, veç tuj mos u dorëzue në këtë kohë të vështirë, ti nanë, do ta qitësh edhe hapin tand të fundit burrnor, që të bon si të gjitha ato nana trimnesha e fisnike shqiptare, të cilat, kur e ka lypë puna e vatanit, s'e kanë kursye e s'e kanë kajtë me lot jetën e djemve të tyne dhe kanë këndue atëherë kur kanë kukatë qyqet", -i shkruan ai nënës së tij.

E pikërisht nëna, shtëpia dhe vendlindja, janë ato të cilave u falen heronjtë, siç thuhet në vargjet e poezisë "Do të kthehem":

Kthehu shpejt më ke pas thënë

Se brengat më kanë molisur
Të presin shokët një varr nën bli

Porositë e babit tënd

Kaluan pranvera e vjeshta o nanë
Që kur ti e ndjell veç një kthim
Nëse vetë nuk do të mundem
Do i them birit tim

Në vendlindje le të shtrojë çdo gëzim

Ne sot e përjetë do ta nderojmë kujtimin për të, për Bardhoshin e Kadri Zekën, sepse ata e meritojnë, sepse shteti ynë e mbanë vullën e tyre.

Mirënjohje nga Asociacioni i Atasheve të Mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut

Ministrja e Mbrojtjes Shekerinska: Vendi dhe qytetarët e tij duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s

Ministrja e Mbrojtjes Radmilla Shekerinska, merr mirënjohjen nga Asociacioni i Atasheve të Mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut, siq tha presidenti i saj, atasheu i mbrojtjes i SHBA-së, kolonel Piter Rauell, për "udhëheqjen e saj në procesin e anëtarësimit të vendit tonë në Aleancë dhe vizionin e saj për zhvillim të Mbrojtjes dhe Armatës në përputhje me standardet e Aleancës". Mirënjohja iu dha ministres Shekerinska pas konferencës së rregullt vjetore me përfaqësuesit e ushtrive aleate.

Ministrja Shekerinska falënderoi për këtë gjest dhe tha se katër vitet e gjysmë ishin të vështira, por edhe se e gjithë ajo punë dha rezultat sepse rezultati është i dukshëm.

"Nuk ka kënaqësi më të madhe se mundësia për të kontribuar për kombin, për vendin, për qytetarët. Kam pasur mundësinë të kontribuoj për diçka më të madhe se vetja. Nëse ka një fjali që e kemi përsëritur në dekadat e fundit, ajo është se vendi dhe qytetarët e tij duan të jenë pjesë e Bashkimit Evropian dhe NATO-s", -tha ministrja Shekerinska, duke shtuar se në katër vjet e gjysmë kemi përfunduar detyrat tona të shtëpisë dhe anëtarësimi në NATO ka treguar se përkushtimi dhe puna e palodhur sjellin rezultate.

Ajo falënderoi atashetë e mbrojtjes për mbështetjen e vazhdueshme, për të gjitha këshillat, për forcën që na dhanë në momente të vështira për të ecur përpara.

"Partnerët dhe aleatët na dhanë



forcë kur humbëm. Ju besuat tek ne kur ne vetë kishim dyshime. Ju na keni dhënë këshilla të singerta dhe miqësore, dhe ato këshilla ndonjëherë janë më të vështirat për t'u dëgjuar dhe kuptuar. Por ato këshilla janë më të mirat që mund të jepen dhe unë ju falënderoj për këtë", -tha ministrja Shekerinska për atashetë e mbrojtjes.

Ceremonia e ndarjes së mirënjohjes u parapri nga një konferencë e rregullt vjetore me atashetë e mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut, në të cilën ministrja Shekerinska iu referua arritjeve në mbrojtje në vitin 2021.

Vitin e kaluar ministrja Shekerinska e vlerësoi si vit të vështirë por jashtëzakonisht të suksesshëm për mbrojtjen.

"Në përvjetorin e parë të anëtarësimit në NATO, kemi përfunduar integrimin tonë ushtarak në Aleancë dhe aleatët tanë na kanë përgëzuar që ky është integrimi më i shpejtë ushtarak i një shteti anëtar deri më sot. Vitin e mbyllëm

me 98.6% realizim të buxhetit – mjeteve, shumica e të cilave ishin të destinuara për modernizimin e Armatës. Kemi investuar në kapacitetet e Krivollakut, i cili po bëhet poligoni më i mirë për aleatët në Europë, kemi konfirmuar se Maqedonia e Veriut është anëtare e NATO-s që kontribuon në sigurinë rajonale dhe aftësinë e Aleancës për të përballuar çdo sfidë. Mbi të gjitha ne kemi investuar në aleancë, unitet dhe vlera të përbashkëta. E gjithë kjo nuk do të ishte e mundur pa mbështetjen e vazhdueshme të atasheve të mbrojtjes të akredituar në Maqedoninë e Veriut. Suksesi ynë është konfirmimi më i mirë i parimit të NATO-s – së bashku jemi më të fortë!", -tha ministrja Shekerinska.

"Duke pasur parasysh të gjitha sfidat e sigurisë, viti 2021 na ka dhënë shumë mundësi për të qenë më të mirët në atë që bëjmë si udhëheqës dhe për t'i bërë institucionet tona më të forta dhe më elastike ndaj kërcënimeve të reja", -u tha ministrja atasheve të mbrojtjes.

Me një ceremoni në Ministrinë e Mbrojtjes, Slavjanka Petrovska e mori postin e ministres së Mbrojtjes nga ministrja aktuale Radmilla Shekerinska.

Në fjalën e saj të parë si ministre e Mbrojtjes, Petrovska tha se e merr këtë post në rrethana shumë të ndryshme socio-politike nga ato që ishin në vitin 2017 dhe se sot vendi ynë është anëtar i NATO-s, që kërkon shumë punë, përkushtim dhe sakrificë politike që e gjithë kjo të bëhet realitet. Ministria falënderoi ministrën aktuale Shekerinska për investimin dhe kontributin e saj në përmbushjen e këtij zotimi strategjik.

"Anëtarësimi në NATO nuk është vetëm një njohje e proceseve politike që kanë ndodhur, por edhe e gatishmërisë së Armatës sonë për të pranuar standardet e NATO-s dhe parimet e veprimit të Aleancës. Gjeneral Gjurginovski, Ju përgëzoj ju dhe pjesëtarët e Armatës për angazhimin e deritanishëm në këtë proces jashtëzakonisht të rëndësishëm, pjesë e rëndësishme e së cilës padyshim jeni. Së bashku do të vazhdojmë në atë rrugë", -tha ministrja.

Petrovska tha se do të jetë një shtytës i fuqishëm i zhvillimit në Mbrojtje dhe proceseve që tashmë kanë filluar, të cilat do të realizohen me dinamikë edhe më intensive.

"Një nga prioritetet më të rëndësishme gjatë mandatit tim do të jetë ruajtja e qëndrueshme e financimit të Mbrojtjes dhe arritja e 2% të PBV-së për buxhetin e Mbrojtjes deri në vitin 2024. Projektet për pajisjen dhe modernizimin e Armatës do të vazhdojnë të realizohen, do të vazhdoj të kujdesem për përmirësimin e kushteve të punës dhe standardit jetësor të personelit ushtarak dhe civil në Armatë. "Do të vazhdojë përmirësimi dhe rinovimi i infrastrukturës së objekteve ushtarake, si dhe rinovimi i objekteve me implementimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë dhe sigurisht do të vazhdojë investimi në zhvillimin e poligonit ushtarak "Krivolak", i cili është një resurs i vlefshëm vendor dhe i NATO-s", -tha Petrovska.

Znj. Petrovska tha se do të ruhet niveli i lartë i transparencës dhe integritetit në punë, do të merret parasysh përfaqësimi i drejtë dhe zbatimi i politikave korrekte gjinore në Mbrojtje dhe Armatë.

Lidhur me bashkëpunimin me aleatët, me të cilët ndajmë vlera të njëjta, ministrja Petrovska tha se do të zhvillojmë ndërveprueshmërinë dhe

Slavjanka Petrovska merr postin e ministres së Mbrojtjes nga Radmilla Shekerinska



do të vazhdojmë të marrim pjesë në operacionet dhe misionet ndërkombëtare paqeruajtëse.

Ministrja aktuale e Mbrojtjes Shekerinska theksoi se mbrojtja në 4 vite e gjysmë ishte pjesë e diçkaje më të madhe se ne dhe se është shkruar një histori që ia vlen të kujtohet. "Më kujtohet 4 vite e gjysmë më parë kur thashë se do të ndryshonim "status quo"-në në Mbrojtje. Sot Mbrojtja nuk njih "status quo". Sot nuk ka asnjë problem që është i pazgjidhshëm. Sot sistemi funksionon. Arritëm ta kthejmë Republikën e Maqedonisë së Veriut në procesin e integritetit në NATO-s, jemi anëtare e NATO-s, të njëjtë dhe të barabartë me të tjerët, të integruar ushtarakisht në një kohë rekord në historinë shtatë dekadëshe të Aleancës. Në vitin 2017 thashë se pjesëtarët e Armatës që ruajnë këtë vend do të marrin dinjitetin dhe respektin që u takon me një standard më të lartë dhe kushte më të mira pune, me kujdes të treguar qartë nga shteti. Sot ky është një realitet," -tha Shekerinska.

Ministrja aktuale falënderoi stafin e Mbrojtjes dhe pjesëtarët e Armatës, sepse siç tha ajo, sinjeriteti, ndershmëria dhe profesionalizmi i tyre kanë qenë frymëzim dhe motiv për punë edhe më intensive.

"Lidershipi për mua nuk ka qenë asnjëherë një funksion i privilegjit të

statusit apo pozicionit, por vetëm i veprimit, vendimmarrjes, marrjes së përgjegjësisë dhe shembullit personal. Faleminderit që më mbështetët në këtë. Unë shoh tek ju shumë profesionistë të vërtetë që janë të denjë për kushte edhe më të mira pune. Ne e kemi bërë institucionin tonë të parin në shumë gjëra, së pari në transparencë, në krye të Europës për sa i përket integritetit në funksionim. Dhe kjo është gjëja më e rëndësishme, të punohet me integritet, me një motiv të fortë dhe pa kufizime", -tha ajo. "Nuk ia dolëm me pritshmëritë, por i rritëm dhe më pas së bashku i tejkaluam. Jam e bindur se do të vazhdoni në këtë. Jam e bindur se rezultatet do të vazhdojnë të vijnë dhe do të jetë kënaqësia ime personale që sistemi që kemi ngritur ka vazhduar të rritet. E kam ditur gjithmonë se liria që kemi luftuar për të së bashku në disa raste është shumë e rëndësishme për ne. Ajo që kam mësuar në vitet e fundit është se liria shkon vetëm së bashku, ajo jeton, mbron dhe zhvillohet së bashku me përgjegjësinë. Liria vërtetë kërkon përgjegjësi, përgjegjësi për të bërë një ndryshim, për të kontribuar, për të përmirësuar dhe për të arritur më shumë. Vazhdoni të mbroni atdheun dhe lirinë, me punë të përkushtuar dhe rezultate të dukshme", -përfundoi Shekerinska në fjalimin e fundit si ministre e Mbrojtjes.



"Çdo grua që kupton problemet e mbarëvajtjes së një shtëpie është shumë më afër kuptimit të problemeve të mbarëvajtjes së një vendi"

(Margaret Thatcher)

Të drejtat e grave

Punoi: Anjeza Musollari
Shefe e Sektorit të Botimeve

Të drejtat e grave janë të drejtat themelore të njeriut, të cilat u ruajtën nga Kombet e Bashkuara për çdo qenie njerëzore në planet rreth 70 vjet më parë. Këto të drejta përfshijnë të drejtën për të jetuar pa dhunë, skllavëri dhe diskriminim; të arsimohen; të posedojnë pronën e tyre; të drejtën për të votuar; dhe për të fituar një pagë të drejtë dhe të barabartë. Megjithatë pothuajse kudo në botë, grave dhe vajzave ende u mohohen të drejtat, shpesh thjeshtë për shkak të gjinisë së tyre. Të drejtat fitimtare për gratë janë më shumë sesa dhënia e mundësive për çdo grua ose vajzë individuale; po ashtu po ndryshon se si punojnë vendet dhe

komunitetet. Ai përfshin ndryshimin e ligjeve dhe politikave, duke fituar zemrat dhe mendjet, dhe duke investuar në organizata dhe lëvizje të fuqishme të grave. Gratë kanë qenë të detyruara që për një kohë të gjatë të luftojnë për njohjen dhe pranimin e tyre si qenie të plota njerëzore dhe pranimin e të drejtave të tyre themelore, por fatkeqësisht, kjo luftë vazhdon edhe sot.

Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave nuk janë vetëm të drejta njerëzore, ato janë gjithashtu të domosdoshme edhe për arritjen e një zhvillimi përfshirës, të barabartë dhe të qëndrueshëm. Trajtimi i grave nga ana e shoqërisë, e cila në shumë vende/shoqëri ka qenë e organizuar dhe e dominuar nga burrat, nënkuptonte se gratë nuk gëzonin të drejta të barabarta me burrat në shumë sfera të ndryshme të jetës. Rrethanat e tilla si Luftërat Botërore nënkuptonin

se roli i grave shihej përmes një perspektive të ndryshme, dhe jo vetëm lindja e fëmijëve dhe të qenit amvisë. Gjatë luftërave, gratë në tërë botën kanë kontribuar në mënyra të ndryshme. Në shumë pjesë të Evropës, si në Britaninë e Madhe, pozita e grave në shoqëri ka ndryshuar në mënyrë drastike, si rezultat i luftërave. Një feministe udhëheqëse në Angli, znj. Millicent Fawcett, kishte thënë se "lufta kishte revolucionarizuar pozitën industriale të grave – ajo i kishte gjetur ato shërbëtore dhe i kishte lënë pas të lira". Kështu nisur nga ky këndvështrim, të jesh femër në të kaluarën konsiderohej si fatkeqësi sepse ato nuk kishin asnjë të drejtë si qenie njerëzore. Pra në periudhat e hershme femrat trajtoheshin njëllë sikur skllavërit dhe varësisht prej civilizimeve të mëparshme atyre u përshkruheshin tipare të ndryshme.

Në Europë tregtia me femra

ishite diçka e zakonshme deri në vitin 1805, sipas kinezëve gruaja ishte gjëja më e pavlerë kurse sipas romakëve burri kishte të drejtë të braktisë apo edhe ta vrasë gruan. Kështu që të drejtat e tyre ato i kërkuan për herë të parë në shek. XIX përmes Lëvizjes Feministe. Kjo lëvizje merrej me të drejtën e votimit, arsimimit dhe punësimit të tyre. Vendet e para në të cilat u kërkuan këto të drejta ishin: Në Francë dhe Holandë 1872, Angli 1890, kurse në SHBA 1910. Ndërsa për sa i përket të drejtave të votës për gratë ka qenë një lëvizje e madhe ajo që bëri të mundur këtë të drejtë.

Edhe pse e drejta e votës nuk ka qenë e njohur për të gjithë, pasi që një numër i sistemeve nuk kanë qenë demokratike. Shumë vende në Evropë, për shembull, kanë qenë monarki absolute, që do të thotë se një Mbretëreshë ose Mbret kanë sunduar popullin dhe vetëm një grup i kufizuar njerëzish (ata që ishin të pasur) gëzonin disa privilegje. Ndërkohë, vendet që më vonë kishin përvetësuar komunizmin kishin një formë të ndryshme të organizimit, i cili mbështetej në kontrollin e tërë aktivitetit ekonomik dhe shoqëror nga një sistem totalitar i dominuar nga një parti politike. Prandaj, në të dyja sistemet ose nuk ka pasur votime ose nëse ka pasur, ato ka qenë për një numër të vogël të privilegjuarish, ndërsa në asnjërin nuk ka pasur zgjedhje të lira. Megjithatë, edhe me demokratizimin e vendeve gratë nuk ishin njohur menjëherë si individë me të njëjtat të drejta të njeriut si burrat, dhe shumë vende kishin dështuar të njihnin të drejtën universale të votimit.

Gruaja zë një rol shumë të rëndësishëm në ditët e sotme në shoqëri, nëse i kthehemi kohës prapa, do të shohim se gratë janë përballur me shumë padrejtësi dhe kanë luftuar fort për të fituar të drejtat e tyre. Gratë janë konsideruar "qenie të pa vlera" dhe të "paafte", inferiore ndaj burrave dhe të pa afta për të arritur sukses. Me kalimin e kohës, gratë sot këto barrierat mendore dhe kompleksitetet i kanë zhdukur, dhe shoqëria

e njeh rolin tejet të rëndësishëm që gratë e kanë në ditët e sotme. Gratë arrijnë të marrin arsimimin më të mirë dhe zotërojnë një sërë aftësish dhe kualifikimesh që kanë dhënë rezultate të kënaqshme në botën e punës. Po ashtu gratë kanë arritur të zënë poste prestigjioze, të drejtojnë si dhe të jenë pjesë e institucioneve shtetërore, ato tani nuk ndihen inferiore ndaj burrave dhe arrijnë të marrin vendime të rëndësishme dhe të jenë presidente të një shteti. Përkushtimi dhe puna e tyre ka bërë që shumë kompani sot të preferojnë gratë ndaj burrave për zgjedhjen e çështjeve me rëndësi, numri i grave që punojnë është rritur dhe ky faktor ka bërë që ato të kenë fituar pavarësinë e tyre. Edhe roli i saj në familje ka ndryshuar, nëse

dhe qëllimit, tregon se ndikimi i tyre çon në motivim më të madh dhe rezultate më të mira. Një përfitim i lidërshipt femëror është një rritje në masat për të nxitur ekuilibrin e punës dhe familjes, i cili është i rëndësishëm për zhvillimin e vendit, si dhe për përmirësimin e cilësisë së jetës së familjeve. Sipërmarrja e grave dhe prania e grave në ekipet e menaxhimit kanë një ndikim pozitiv në motivimet sociale dhe arritjet e organizatave. Me gratë në krye, kompanitë janë më të prirura për të futur politikatat miqësore familjare. Konteksti i ri bashkëkohor sipërmarrës i sotëm është më i favorshëm për këtë lloj qasjeje sesa në botën tradicionale të biznesit. Në fakt, ndërmarrjet me bazë në komunitet janë shfaqur si instrumente kyçe të fuqizimit



dikur familjet ishin patriarkale, sot ka një balancim të autoriteteve dhe mendimi i gruas ka shumë peshë. Megjithatë nuk duhet anashkaluar fakti që shumë gra, sidomos në zonat rurale nuk kanë fituar ende rolin që u takon, ato janë ende të nënshtruara dhe ka raste kur këto gra janë viktima të një mentaliteti mesjetar.

Sot gruaja ka ndikim të madh në politikën e një vendi po ashtu prania e grave në ekipet e menaxhimit përgjithësisht shoqërohet me një angazhim më të fortë shoqëror dhe me një stil lidërshipi më pjesëmarrës. Një analizë e ndikimit të grave në ndërmarrjet bashkëpunuese, të cilat kanë karakteristika të veçanta në kuptim të organizimit

të grave. Po ashtu si në biznes ashtu edhe në politikë, shumica thonë se gratë janë më të mira se burrat kur bëhet fjalë për të qenë të dhembshur dhe të ndjeshëm, dhe aksionet thelbësore thonë se gratë janë më të mira në kompromiset dhe qëndrimin për atë që besojnë.

Lidërshpi i femrës është kthyer të jetë një fakt i epokës post moderne. I shfaqur si një fenomen i natyrshëm në të gjitha nivelet ai ka sjellë tipare që padyshim kanë tërhequr vëmendjen e studiuesve. Pothuaj të gjithë teoricienët e lidërshipt arrijnë në një pikë të përbashkët mendimi: lidërshipi femëror prezanton tiparet e lidërshipt transformues, shpirtëror,

pjesëmarrës e mbi të gjitha atij shërbëtor. Gjithashtu, të gjitha studimet njëzëri arrijnë në përfundimin se femrat në krahasim me meshkujt kanë një nivel më të lartë të inteligjencës emocionale dhe ky është një tjetër faktor që i bën ato të suksesshme në misionin e liderit. Sipas shumë studimeve shkencëtarët kanë ardhur në përfundim se femrat kanë përparësi në udhëheqje në krahasim me meshkujt

Disa nga format dalluese të lidereve gra janë:

- 1- Femrat kanë aftësinë dhe durimin të dëgjojnë dhe shfaqin tolerancë.
- 2- Femrat është e prirur të japë dashuri.
- 3- Askush më shumë se një femër mund të njohë artin.
- 4- Femrat janë sakrifikuese të mëdha.
- 5- Femrat janë të prirura për marrjen e iniciativës dhe dëshira e madhe për sukses dhe rezultate.

Në vitet e fundit për sa i përket pozitive udhëheqëse të femrave po ndryshon, çdo ditë e më shumë shohim drejtuese femra në administratë publike, në pozita udhëheqëse të larta ekzekutive shtetërore, në pozita ekzekutive në kompani të mëdha dhe kjo po reflekton dhe në organizatat e shoqërive civile dhe për rrjedhojë edhe në sipërmarrje. Tani shohim që femrat janë të lira të demonstrojnë aftësitë e veta dhe të konkurrojnë në mënyrë të barabartë me një burrë, duke fituar terren në pozicionet e drejtuar deri dhe nga meshkujt. Ndërkohë që burrat dhe gratë janë dy modele të ndryshme në udhëheqje, studimet e sociologeve dhe të psikologëve tregojnë se burrat janë më shumë të përqendruar te pushteti në kuptimin e prestigjit dhe statusit në hierarkinë shoqërore, ndërsa femrat bazohen në ndikimin përmes bashkëpunimit me të tjerët duke kërkuar për mendime dhe këshilla. Ndërsa për sa i përket fushave në të cilat më së shumti dominojnë femrat është administrata, pra kjo është fusha në të cilën gjith-


një e më tepër po shtohet numri i femrave dhe përveç posteve të zakonshme në administrata po shtohen udhëheqëset femra.

Disa prej femrave të suksesshme në botë

Angela Dorothea Merkel, u lind më 17 korrik të vitit 1954 në Hamburg të Gjermanisë Perëndimore.

Angela Merkel është grua e pazakontë, ajo është pjesë e politikës federale gjermane. Vetëm një vit pas angazhimit të saj të parë të mirëfilltë politik, gjatë kohës së kthesës, ajo ishte bërë tashmë deputete e Bundestagut dhe ministre, më vonë u bë sekretare e përgjithshme e Unionit Demokristian të Gjermanisë (CDU-së) dhe si gruaja e parë në historinë e një partie popullore gjermane, madje u bë edhe kryetare federale e CDU-së. Kështu që Angela Merkel ose siç njihet ndryshe si "gruaja e hekurt" është një nga tre kancelarët e vetme që ka arritur të marrin mandatin e

në Politikën Europiane prandaj në vitin 2014 u zgjodh si personi i vitit nga revista prestigjioze New Your Times. Më 22 nëntor 2005, Merkel mori detyrën e kancelares së Gjermanisë pas bllokimit të zgjedhjeve që rezultoi në një koalicion të madh me SPD. Pra Angela Merkel bëhet kancelarja e parë femër e Gjermanisë dhe e para nga Gjermania Lindore që merr këtë post. Ajo bën pjesë në grupin e liderëve më me ndikim në botë dhe nga gazetarët e Britanisë të Madhe ajo është cilësuar si ish kryeministria e tyre Margaret Thatcher, madje ata e cilësojnë Merkelin me të njëjtin pseudonim si Thatcher duke e quajtur si "Gruaja e hekurt" gjermane. Merkel u angazhua edhe në politikën e shteteve të Ballkanit Perëndimor, sidomos për ndikimin e dialogut mes Kosovës dhe Serbisë, që mes shteteve të arrihet një marrëveshje në të mirë të të dyja shteteve. Dhe ndikimi i saj për shtetin tonë është mjaft i madh për angazhimin dhe hyrjen



tretë. Gjatë udhëheqjes së saj, shumë gjëra ndryshuan në favor të shtetit të Gjermanisë si: rritja ekonomike, hapja e shumë vendeve të punës, përparimi në reformat shtetërore e arsimore. Angela Merkel përveçse ishte kancelare e shtetit gjerman ajo gjithashtu luajti rol shumë të rëndësishëm

e Kosovës në Bashkimin Europian (BE).

Hillary Diane Rodham Clinton, ka lindur më 26 tetor të vitit 1947, ajo u lind në Çikago, Illinois. Ajo fillimisht u angazhua në politikë, si studente në Wellesley College në vitin 1969 pastaj dhe u diplomua



si juriste në vitin 1973 në Universitetin e Jalës. Pas diplomimit ajo u bë një avokate e shkëlqyer, duke këshilluar Fondin e Mbrojtjes të fëmijëve të Cambridge, përpara se të bashkohet me ekipin e juristëve që këshillonin për Komisionin Juridik përfaqësues gjatë fajësimit të Presidentit Richard Nixon. Ajo u martua me diplomatin e shkollës juridike Bill Clinton në vitin 1975. Në fillim të vitit 2007, Clinton njoftoi planet e saj për të kandiduar për presidencë. Gjatë vitit 2008, ajo pranoi emërimin kur u bë e qartë se Barak Obama mbajti shumicën e votës së delegatëve. Pas fitimit të zgjedhjeve kombëtare, Obama caktoi atë si sekretaren e SHBA-ve. Ajo u betua si pjesë e kabinetit të tij në Janar 2009 dhe shërbeu deri në vitin 2013. Në pranverën e vitit 2015, ajo njoftoi planet e saj për të kandiduar përsëri për presidencën e SHBA-ve. Në vitin 2016, ajo u bë gruaja e parë në historinë e SHBA-së që u bë kandidati presidenciale i një partie të madhe politike. Pas një fushate polarizimi kundër kandidatit të GOP Donald Trump, Klinton u mund në zgjedhjet e përgjithshme. Si një zonjë e parë shteti, si një senatore dhe si një politikanë me ndikim të madh në politikën amerikane Hillary dhe bashkëshorti i saj Bill Clinton, kanë bërë shumë të mira për vendin tonë prandaj edhe zëri dhe fuqia e saj kanë mjaft ndikim edhe në shtetin

tonë, sepse përkrahja dhe ndihma e tyre për ne, ka qenë dhe është mjaft e madhe.

Madeline Korbelt Albright, ka lindur më 15 maj 1937 në Pragë, Çekosllovakia (tani Republika Çeke). Ishte femra e parë në postin e sekretarit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, politikane dhe diplomate amerikane. Madeleine Albright është ish sekretarja e parë femër dhe njëherazi e nominuar nga presidenti i atëhershëm Bill Clinton dhe e konfirmuar si e tillë nga senati me 99 vota për asnjë kundër. Ajo ishte në postin e sekretares së Shteteve të Bashkuara të Amerikës nga 23 Janari i vitit 1997 deri më 20 Janar të vitit 2010. Ajo bashkë me presidentin Bill Clinton kanë qenë ndër më kryesorët për çlirimin e Kosovës nga okupimi serb dhe kanë kontribuar në vazhdimësi për lirinë dhe pavarësinë e saj.

Margaret Hilda Thatcher, lindi më 13 tetor 1925 në Grantham.

Margaret Hilda Thatcher, Baronesha Thatcher ishte politikane Britanike dhe Kryeministrja e Mbretërisë së Bashkuar nga 1979 në 1990 si dhe drejtuesja e Partisë Konservatore. Ajo ishte kryeministrja britanike që shërbeu më gjatë e shekullit të 20-të dhe është e vetmja grua që ka mbajtur këtë detyrë. Një gazetar sovjetik e qua-

jti atë "Zonja e Hekurt", një nofkë që karakterizoi politikën e saj pa kompromis dhe stilin udhëheqës. Si Kryeministre, ajo zbatoi politika që njihen si Theçerizëm.

Fillimisht një kimiste para se të bëhej avokate, Thatcher u zgjodh anëtare e Parlamentit për zonën zgjedhore Finchley, në vitin 1959. Edward Heath e emëroi atë Sekretare të Shtetit për Arsimin dhe Shkencën në qeverinë e tij të vitit 1970. Në vitin 1975, Thatcher mundi Heath në zgjedhjet e udhëheqjes së Partisë Konservatore për t'u bërë kreu i Opozitës dhe u bë gruaja e parë të udhëhiqte një parti të madhe politike në Mbretërinë e Bashkuar. Filozofia e saj politike dhe politikat e saj ekonomike theksuan çlirimin nga rregullat të sektorëve të ekonomisë (veçanërisht të sektorit financiar), bërjen e tregjeve të punës më fleksibël, privatizimin i kompanive shtetërore dhe uljen e fuqisë dhe ndikimit të sindikatave. Popullariteti i Theçerit gjatë viteve të saj të para në detyrë filloi të bjerë për shkak recesionit dhe papunësisë së lartë, deri në 1982 kur Lufta e Falklandeve solli një rigjallërim të mbështetjes, duke rezultuar në rizgjedhjen e saj në vitin 1983. Thatcher u rizgjodh për një mandat të tretë në vitin 1987. Gjatë kësaj periudhe mbështetja e saj për një Taksë të Komunitetit (gjerësisht referuar si "taksë votimi") ishte gjerësisht jopopullore dhe pikëpamjet e saj mbi Komunitetin Europian nuk përputheshin me atë të disa pjesëtarëve të kabinetit të saj. Ajo dha dorëheqjen si kryeministre dhe udhëheqja e partisë në nëntor 1990, pasi Michael Heseltine nisi një sfidë për udhëheqjen e saj. Pas largimit nga Dhoma e Ulët (Commons) në vitin 1992, asaj iu dha titulli Baroneshë e Kesteven në qarkun e Lincolnshire, që i jepte asaj të drejtën të mernte pjesë në Dhomën e Lordëve. Ajo u tërhoq nga paraqitjet publike për shkak të shëndetit të saj. "Nëse kritikët e mi do të më shihnin duke ecur përmbi ujërat e deteve ata do të thoshin se kjo ndodh për shkak se unë nuk di të notoj", -Margaret Thatcher. Kjo është femra!

Beteja të rregullta të ushtrisë shqiptare


Lufta e rregullt në periudhën e ushtrisë së mesjetës kryhej nëpërmjet ndeshjes në fushë të hapur të masës kryesore të forcave të të dy palëve, të cilat ishin të rreshtuara përballë njëra-tjetrës ose e fillonin luftimin me afrimin në fushën e betejës. Të kësaj natyre janë një varg i tërë betejash të zhvilluara ndërmjet ushtrisë shqiptare, të udhëhequra nga Skënderbeu dhe ushtrisë osmane. Por beteja e Torviollit dhe e Albulenës kanë plotësisht tiparet e luftës së rregullt.

Në fushën e Torviollit, ku u zhvillua dhe beteja e parë në qershor të vitit 1444, ishin përballë njëra-tjetrës forcat osmane me një efektiv prej 25.000 këmbësorë e kalorës dhe shqiptarë, 9.000 luftëtarë në fushë të hapur, si dhe 6.000 kalorës e këmbësorë të vendosur në mënyrë të fshehtë, në shpinë të rendimit luftarak. Pas luftimesh të ashpra të palëve, në një moment të vështirë Skënderbeu futi në luftim rezervën e maskuar, e cila përcaktoi dhe fatin e betejës, që përfundoi me shpartallimi e plotë të ushtrisë osmane.

Beteja e Torviollit e zhvilluar në fushë të hapur ku të dy palët ishin të rreshtuar përballë njëra-tjetrës, përmbush të gjitha kriteret e një beteje sipas modeleve të luftës së rregullt. Beteja farkëtoi bashkimin luftarak të popullit shqiptar dhe forcoi simpatinë e besimin e tij te Skënderbeu. Beteja pati jehonë të madhe jashtë Shqipërisë dhe i bëri fuqitë europiane të drejtojnë vëmendjen e tyre nga Shqipëria.

Beteja në të cilën Skënderbeu shfaqti largpamësi, aftësi mahnitëse dhe nivel të lartë strategjik, ishte beteja e Albulenës e zhvilluar në verën e vitit 1457. Kjo ishte ndër betejat më të mëdha mësymëse të zhvilluara në fushat e Evropës gjatë shekujve XV-XVI.

Veprimet luftarake filluan me një tërheqje të thellë strategjike mashtruese të ushtrisë shqiptare, nga brezi kufitar në drejtim të Lezhës, për të krijuar te komanda osmane bindjen e gabuar se forcat shqiptare ishin të paorganizuara e të paafta për të përballuar ushtrinë e tyre të



Dukuri të betejave të Skënderbeut

madhe, që e detyroi Skënderbeun të kërkonte ndihmë te Venediku. Më pas vijoi një heshtje e plotë prej 4-5 javëve e forcave të Skënderbeut, që e bëri mashtrimin tërësisht të besueshëm. Në të tilla rrethana si vigjilenca e komandës, ashtu dhe disiplina e gatishmëria luftarake e forcave osmane të përhapura në mënyrë të çrregullt në fushën e Albulenës, po shkonin drejt rënies. Shturja e disiplinës dhe vapa e madhe e gushtit e dobësuan aftësinë luftarake të ushtrisë osmane. Ideja e mashtrimit të Skënderbeut ishte realizuar me shumë sukses.

Në momentin e përshtatshëm në mesditën e 7 shtatorit, luftëtarët e Skënderbeut kishin zënë në mënyrë të befasishme lartësitë në lindje të fushës së Albulenës, dhe kaluan në mësymje të vrullshme e të fuqishme duke e gjetur në befasi të plotë ushtrinë osmane. Humbjet e para për osmanët e tmerruar e në panik, ishin shumë të mëdha. Mbas përpjekjeve për t'u organizuar, luftimi mori tërësisht pamjen e betejës së rregullt, por zotërimin e gjendjes dhe epërsinë morale i kishin forcat shqiptare. Veç humbjeve të shumta që forcat osmane pësuan në fushën

e betejës, grupime të çrregullta trupash asgjësoheshin nga pritrat e ngritura në rrugët e tërheqjes. Fitorja ishte mahnitëse.

Metoda të luftës

Çështja e metodave të luftës së armatosur, të përdorur nga Skënderbeu në krye të një ushtrie të vogël kundër ushtrisë më të madhe e në mënyrë të fuqishme të kohës ka qenë e diskutuar nga studiues të huaj. Shumë prej tyre duke kërkuar shkakun e fitoreve, mundohen ta gjejnë atë në karakterin malor të vendit dhe në kështjellat e forta. Por në Ballkan ka vende me terren malor e të thyer por, pavarësisht qëndresës, nuk e përballuan dot furinë e sulmeve të ushtrisë osmane. Ndërmjet dy elementeve më kryesorë të luftimit njeriut dhe terrenit, shkaku kryesor i fitores ishin njerëzit, shpirti i atdhedashurisë, heroizmit masiv dhe vendosmëria e tyre për të përballuar çdo sakrificë, ishte forca dhe trimëria e tyre që siç e pohojnë vetë armiqtë "si tigra kthetër-fortë dhe luftarakë, luftonin edhe me retë që kalonin sipër tyre".

Historiani zviceran Schmid ka një tendencë të theksuar për të ulur vlerat e Skënderbeut e të veprës së tij, që e vlerësojnë Skënderbeun si një strateg vetëm të luftës guerile, si një komandant çetash të malësorëve. Natyrisht që Skënderbeu ishte një komandant shumë i zoti i luftës guerile, por ishte dhe strateg e komandant i zoti i luftës së rregullt. Analiza e luftërave dhe betejave të zhvilluara tregoi qartë se Skënderbeu, ishte njohës i thellë i artit ushtarak dhe kombinoi me mjeshtëri luftën e rregullt me luftën guerile. Për t'u ndeshur me kundërshtarin i duheshin si metodat e luftës partizane, ashtu edhe beteja në fushë të hapur, për të ndëshkuar një ushtri të rregullt. Ushtria e Skënderbeut me mundësi mobilizimi të paktë në luftëtarë, duhej të ishte e aftë të përhapej me shpejtësi në fushën e luftës. Kjo ushtri përbëhej nga garda pretoriane, repartet e kufirit dhe forcat ndihmëse. Strategjia e Skënderbeut kishte vlerësuar drejt sasinë dhe cilësinë e ushtrisë në pikëpamje të cilësisë e morale dhe të aftësive taktike e profesionale. Në kompletimin e ushtrisë, Skënderbeu vendosi parimin "burrë për shtëpi" dhe hartoi listat e rekrutimit. Sistemi kishte tipare të shërbimit të detyrueshëm ushtarak, që ishte mjaft i përhapur në atë kohë. Ai jepte mundësi për realizimin me shpejtësi

të mobilizimit të përgjithshëm të popullit në luftë. Skënderbeu, kështu krijoi i pari në Evropë në periudhën e mesjetës ushtrinë e përhershme dy vjet para Karlit XII në Francë, i cili, vetëm në vitin 1445 krijoi një lloj ushtrie të përhershme.

Manovër strategjike

Fitorja e Albulenës ishte rrjedhojë e manovrës së thellë strategjike e cila bëri të mundur mashtkrimin e armikut dhe nxjerrjen e forcave në kushte të përshtatshme, si në pikëpamje të terrenit, ashtu dhe të befasisë së goditjes. Kjo manovër me përmasa të mëdha dhe me një ide të qartë, nuk njihej atëherë jo vetëm nga ushtritë e vogla të vendeve të Europës, por edhe nga ushtria e madhe osmane. Kështu, ndërtimi i formacionit të luftimit, mënyra e zhvillimit të mësymjes dhe rezultatet që u arritën, i japin betejës së Albulenës tiparet e një beteje fushore të përmasave të mëdha, e të zhvilluara sipas të gjitha kërkesave të luftës së rregullt. Kjo betejë është një ndër betejat kulmore të historisë së luftërave që mund të arrihen nga strategë e komandantë të mëdhenj, me vizion e personalitet të veçantë e që gëzojnë adhurimin e besimin e plotë të ushtrisë. Ka historianë të cilët edhe pse i pranojnë përmasat e betejës së Albulenës, e vlerësojnë atë si një mësymje masive rezultative dhe mohojnë manovrën strategjike të ushtrisë shqiptare.

Albulena ishte fitorja më e madhe që kishte arritur ndonjëherë Skënderbeu në fushë të hapur. Fitorja në Albulenë pati pasoja tepër të rëndësishme. Sultan Mehmeti II u detyrua të bëjë përpjekje të shumta për të nënshkuar me Skënderbeun paqen. Në pamundësi të saj u detyrua që për disa vjet rresht të heqë dorë nga strategjia mësymëse dhe të kalojë në strategji mbrojtëse. Fitorja e ushtrisë shqiptare pati rëndësi të madhe edhe në planin ndërkombëtar. Me dështimin e përpjekjeve të Perandorisë Osmane për pushtimin e Shqipërisë, dështoi në të njëjtën kohë edhe mundësia e zbatimit të planit strategjik të saj për pushtimin e Europës.

Aftësitë e shumanshme të Skënderbeut nxorën në dritë strategun me famë botërore dhe i dhanë mundësi atij të zhvillojë më tej artin ushtarak që arriti nivelin më të lartë të kohës. Duke përmendur artin ushtarak, Skënderbeu u mbështet në kushtet politike dhe social-ekonomike të Shqipërisë në atë kohë.

I mbështetur në parime të shëndosha, arti ushtarak i Skënderbeut zgjidhi me sukses shumë detyra të ndërlikuara, si krijimi i Forcave të Armatosura, mobilizimi dhe përhapja e tyre për luftë, shfrytëzimi i terrenit dhe përgatitja fortifikuese e tij, organizimi dhe kryerja e zbulimit strategjik, caktimi i qëllimeve, formave e metodave për zhvillimin e fushatave e betejave, organizimi dhe kryerja e manovrës strategjike, krijimi i aleancave ushtarake, etj.

Manuale luftarake

Në mjaft vepra të autorëve europianë nën shembullin e betejave e të taktikës fitimtare të Skënderbeut iu kërkohej sa më shpejt rrugët për dëbimin e osmanëve nga Europa. Taktikat e përdorura nga Skënderbeu në beteja u bënë si të thuash udhëzues për vendimmarrje të manualeve luftarake për burrat e shtetit, strategët dhe luftëtarët e tjerë. Pjetri i Madh urdhëronte përkthimin e librit "Mjelma" të shkrimtarit ukrainas J. Galatovski i shkruar nën shembullin e betejave fitimtare e të taktikës së Skënderbeut botuar në polonisht më 1679, të cilën e mbante vazhdimisht në bibliotekën e tij. Kollokotroni shkruan në kujtimet e tij, se historinë e Skënderbeut e mbante gjithmonë me vete, ndërsa njërit prej bastioneve të kalasë të Mesolongjit iu vu emri i Skënderbeut. Elisabeta do të shënonte me dorën e saj në "Luterusin" e saj më 17 janar 1659 në kujtim të vdekjes së Skënderbeut se këtë ditë vdiq princi i mirë Skënderbe, mbret i Epirit dhe ngadhënjimtar mbi osmanët.

Dëshmi e përhershme e vlerësimit dhe e respektit të thellë, që kanë popujt e tjerë për Skënderbeun, krahas botimeve për të, janë sheshet dhe rrugët e Romës, të Parisit, të Brukselit, të Gjenevës dhe të qyteteve të tjera të vendeve të ndryshme, ku janë vendosur buste e monumente dhe që mbajnë emrin "Gjergj Kastrioti - Skënderbeu".

Figura madhështore e heroit Gjergj Kastrioti Skënderbeu është pasqyruar në një numër shumë të madh veprash të arteve figurave. Galeria Skënderbejane nis që nga vitet e para të shek. XVI e deri në ditët tona. Shumë autorë të Shqipërisë e të huaj kanë bërë portretin e kryetrimt plot adhurim e dashuri. Nuk dua të mbyll sytë pa parë malet e Shqipërisë, dëshmitarë të luftës së atij gjeniu luftëtar, do të shkruante me admirim Ernesto Sabato, ka qenë aty

“Togeri” 6-vjeçar në betejën më të madhe të Botës

PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Miliona ushtarë fëmijë në luftë

Miliona fëmijë vuajtën tmerret e Luftës së Dytë Botërore, miliona të tjerë të mbetur jetimë për shkak të veprimeve ushtarake dhe mizorive të kryera nga trupat brutale pushtuese të Gjermanisë por dhe të kundërpërgjigjes antifashiste botërore. Shumë fëmijë përjetuan tmerret e luftës edhe në Shqipëri, duke iu bashkuar formacioneve antifashiste partizane që tashmë janë të njohura dhe të përgjithësuara edhe në vepra artistike, si partizani Velo dhe mjaft filma të kinostudios “Shqipëria e re”. Ndërkohë që në planetin tonë brezi i fëmijëve të LIIB përjetuan një prej tragjediave më të mëdha të shekujve, ku makineria e luftës solli një brez të përvuajtur. Pjesëmarrës në luftë kanë qenë me qindra mijëra në të dy kampet luftarake. Edhe fëmijët realisht luftuan, veçanërisht në Luftën e Madhe Patriotike të 1941-1945, por edhe më gjerë. Por ka një emër që nuk harrohet lehtë. Sergej Aleshkov është pjesëmarrësi më i ri në Betejën e Stalingradit, 6 vjeç sipas burimeve në Lindje dhe në Perëndim, edhe pse në fakt janë rreth 25 000 fëmijë që u angazhuan dhe luftuan gjatë Luftës së Dytë Botërore, megjithëse arkivat ruse flasin për 3 500 fëmijë gjatë Luftës së Dytë Botërore, me moshë më pak se 16 vjeç, përfshi të rinj të grupeve guerile. Personazhi që sjellim sot për lexuesin është një histori e vërtetë e një djali të mitur që iu bashkua Ushtrisë së Kuqe kur ishte gjashtë vjeç. Kur pushtuesit gjermanë sulmuan fshatin e tij vranë gjithë familjen e tij, djali i vogël Sergej vrapoi në pyll, ku u gjet nga ushtarët sovjetikë, krejt i dobët, i uritur, i traumatizuar dhe i mbuluar me zgjebe nga pickimi i insekteve. Ushtarët e fronit rus e morën nën kujdes dhe posaçërisht nga drejtuesi ushtarak Mikhail Vorobjev. Shpejt do “harronte” dramën e tij familjare dhe do ngrohte zemrën e shpirtin tek luftëtarët e frontit të parë, duke kënduar dhe recituar poezi për ta dhe duke shërbyer në shtabin e regjimentit ushtarak, duke merituar titullin “Bir i Regjimentit”. Ishin këta “fëmijët e luftës”, që kishin harruar të qanin brengat familjare, të ngelur jetim në një Atdhe ngadhënjimtar në fitore, por të mbytur nga dhimbjet e gjakut. Fëmijët e luftës janë heronj dhe meritojnë të përmenden, të shkruhet dhe të zënë vendin e merituar në histori, ndoshta edhe

më shumë se të rriturit, që luftën e kishin “detyrë” dhe “mision”.

Historia e pazakontë e ushtarit 6 vjeçar!

Fëmijë të shumtë gjatë LIIB vdiqën të vetëm në kushte të tmerrshme, ndërsa të tjerët u torturuan dhe u gjymtuan nga hitlerianët që po përpiqeshin të zhduknin popujt sllavë, disa u vranë nga nazistët, që qëllonin fëmijët “vetëm për argëtim”, një pjesë e tyre u degdisën në kampet e punës me idenë e rindërtimit të “Gjermanisë së Madhe”. Nga ana tjetër, fëmijët e rezistencës ndaj mizorive gjermane janë propaganduar për angazhim e trimëri, për heroizma në kufijtë moshorë. Historia e ushtarit më të ri të Ushtrisë së Kuqe është e njohur deri në kufijtë e një legjende pavarësisht se është skalitur në muret e historisë luftarake të fitimtarëve. Është fakt se përpara se të fillonte operacioni gjerman “Barbarosa” ndaj Bashkimit Sovjetik, Sergej Aleshkov jetonte me familjen e tij në një fshat që quhej Gryn në rajonin Kaluga të Rusisë perëndimore. Sergej Aleshkov ishte djali i vogël i familjes “Aleshkov”, vetëm 6 vjeç në verën e 1942-it, pasi ishte lindur më 1936. Pushtuesit gjermanë nazistë ekzekutuan nënën dhe vëllain e tij të madh përpara syve të tij, “për mbështetje ndaj partizanëve rusë”, të Ushtrisë së Kuqe, pasi gjithë burrat e fshatit ishin thirrur nën armë për të përballuar agresionin. Pas vrasjes së familjarëve të tij, ndërkohë që babai i tij kishte vdekur përpara fillimit të luftës, djali i mbetur jetim shpëtoi krejt rastësisht. Kur ende fshati i tij, digjej e bastisej, djali u shpëtua nga shpejtësia e mendimit dhe e veprimit të shpejtë i një gruaje fqinje, që me vetëmohim e hodhi nga dritarja e një kasolleje dhe i bërtiti që të ikte sa më shpejt dhe të fshihej në pyllin pranë fshatit. Kështu djali i vogël arriti të fshihej në pyll, sipas këshillës së fqinjës që e ndihmoi për t’u arratisur. Fëmija brodhi për ditë e natë i plagosur dhe i uritur nëpër pyllin e vjeshtës, por në një nga ditët në vijim atë e gjetën partizanët rusë. Luftëtarët e kishin gjetur Sergejin në kufijtë e mbijetesës, të mbuluar me baltë, të uritur, të veshur me rroba të grisura, por kujdesi për t’i shëruar plagët, dhe pasi e lanë dhe e ushqyen dhe i bënë një uniformë posaçërisht të vogël të Ushtrisë së Kuqe. Kështu që nga ai moment

u bë ushtari më i vogël në front dhe nën mbrojtjen e mbështetjen e trupave të Ushtrisë së Kuqe ndërsa ata luftonin në betejë. Djalit jetim e morën me vete kudo ku shkonin dhe ai bashkë me luftëtarët provoi realisht tmerret e luftës, të manovrave, të sulmit, mbrojtjes dhe të tërheqjes, të marshimeve të gjata përmes linjave gjermane. Në një përballje luftarake Sergei Aleshkov plagoset në këmbë, por ai ishte me fat nga mbështetja e madhe që i bënë luftëtarët e Regjimentit 142 të Këmbësorisë të Ushtrisë së Kuqe, regjiment i cili komandohej nga majori Vorobjov. Në pushimet e luftimeve dhe ndërmjet betejave, ushtari i Regjimentit, ngrinte moralin duke kënduar poezi dhe këngë, dhe gjatë betejave ai transportonte municion në trupat e vijës së parë, duke i mbajtur ato të furnizuara aty ku mbaronte municioni, si dhe me mesazhe të transmetuara që i dërgonte në postë. Gjithë ushtarët e Regjimentit luftarak të vijës së parë të luftës e trajtuan djalit sikur të ishte biri i tyre.

Ushtari 6-vjeçar në frontin e Luftës së Dytë Botërore

Komandanti i Regjimentit Majori Vorobjov ishte bërë më shumë i njohur nga djalit jetim se sa nga sukseset e padiskutueshme luftarake. Kështu ai mundësoi që ta adoptonte ushtarin më të vogël të frontit Sergei Aleshkov dhe bashkë me gruan e tij të dashur, Nina e cila ishte infermiere u bënë më shumë se prindërit e tij biologjikë të rënë në luftë. Në një rast sulmi një bombë goditi vendin ku vepronte regjimenti që drejtohej nga Majori Vorobjov, në sulmin e ashpër që gjermanët bënë gjatë Betejës për Stalingradin. Dheu blloko i hyrjen dhe rrezikonte jetën por i ngelur i bllokuar brenda, me fare pak ajër Sergei u përpoq të hiqte vetë mbeturinat nga hyrja, por nuk ishte mjaftueshëm i fortë, në atë periudhë vetëm 7 vjeç, por edhe në këtë rast ia dolën ta nxirrnin atë gjallë nga rrënojat. Ishte koha kur gjermanët nazistë bombarduan rëndë zonën, ndërsa ushtar Sergei vraponte nëpër zinxhirin e bombave që binin në llogoret përreth, ku u raportonte ushtarëve të frontit se çfarë kishte ndodhur edhe në një rast me majorin Vorobjov që rrezikonte jetën. Njoftimi që u bëri djalit guximtar grupit të shpëtimit bëri që në sa e sa raste të shpëtonte jetë njerëzish. Në këtë betejë nga

më të mëdhatë e njerëzimit mori plagë u gjakos sikurse miliona të tjerë, por pas plagës në këmbë. Pas betejës lajmet për trimërinë e guximin e tij u përhapën në të gjithë Ushtrinë dhe për trimërinë e tij, Sergei Aleshkov u nderua me "Medaljen për Trimëri Ushtarake". Në një rast tjetër në luftë, ndërsa ishte i vendosur në Dnjeper,

djali luftëtar zbuloi dy burra të fshehur në kashtë, të cilët ishin vrojtues raportues të nazistëve dhe që po vëzhgonin në interes të grupeve të zbulimit të artilerisë që po hidhnin predha artilerie mbi zonat civile. Raportimi i tij bëri që zbuluesit gjermanë si dhe artileria e tyre të merrte një kundërgoditje të rrufeshme artilerie. Episode lufte, heroizmi dhe trimërie janë të shumta për këtë bir të regjimentit të dekoruar për trimëri në betejë. Në bilancin e mbrojtësve të Stalingradit ishte padyshim edhe emri "Sergej Aleshkov", pasi në fillim të nëntorit 1942, Regjimenti i 142-të i pushkatarëve të Gardës ishte transferuar në frontin luftarak të Stalingradit, ku për të gjitha veprimet heroike e trimërore edhe ishte vlerësuar me medaljen "Për Merita Luftarake", kjo edhe për veprimin e zgjuar e të shpejtë për nxjerrjen nga rrënojat në një gropë të komandantit të regjimentit major Mikhail Vorobjov që ishte njëherësh edhe babai që e birësoi djalit luftëtar, djalit që u bë shpëtimtari i tij pas plagosjes nga një predhë. Përgjatë gjithë luftës ai u shndërrua në një rritës të moralit dhe besimin në fitore në momente jashtëzakonisht të vështira, prandaj edhe ishte dhe mbeti "i preferuari i regjimentit", shkruhej në urdhrin që i jepte dekoratë ushtarit që sapo kishte mbushur moshën shtatë vjeçare. Bashkë me medaljen "Për merita luftarake", mori edhe një pistoletë nga trofetë, nga një gjeneral i ushtrisë dhe madje u "gradua" në gradën e "togërit të vogël". Lufta e Dytë Botërore po ndryshonte jetën e miliona njerëzve të të gjitha moshave. Të gjithë në kohë lufte rrëmbenin armët, por vetëm një regjiment i Ushtrisë së Kuqe në Frontin Lindor kishte një ushtarak në radhët e tij, i cili ishte vetëm gjashtë vjeç, që pas dekorimit thirrej "Togëri i ri".



"Biri i Regjimentit", në memorie të njerëzimit

Rrugëtimi luftarak i djaloshin Aleshkov ishte tejet e vështirë. Ndërkohë që formacioni luftarak ku bënte pjesë ushtari 6-vjeçar po kalonte një pengesë ujore ai për pak u mbyt. Rasti ishte kur ishin duke kaluar lumin Doni një lumë që rrjedh nga Malësitë Qendrore Ruse drejt ultësirës së Azovit, një ndër lumenjtë që rrjedh përgjithësisht në lindje. Ky lumë bën pjesë ndër lumenjtë më të mëdhenj të Rusisë, si "arterie" strategjike me gjatësi 1870 km. Në një rast tjetër, automjeti me të cilin po udhëtonte ndeshi në një minë, por fëmija mbijetoi për mrekulli. Në një rast, si për shaka, ushtarët e Regjimentit i veshën një uniformë togëri të vogël, por kjo sa si kushtoi jetën djalit të vogël. Rripat me shkëlqim të shpatullave tërhoqën vëmendjen e pilotëve gjermanë, të cilët lësh-

uan një breshëri mitraljere që nga lart nga avioni drejt "oficerit" të ri. Një plumb e goditi djalin që po vraponte në thembër, plagë që i ngeli si kujtim gjatë gjithë jetës, por që babai i tij si dhe ushtarët që e veshën djalin me uniformë togeri e vuajtën shumë dhe qortuan veten. Megjithatë ishte një "kujtim" nga lufta. Lufta përfundoi me fitoren e Aleatëve mbi boshtin Romë-Berlin-Tokio. Bota iu kthye paqes. Këtu kishte përfunduar edhe rrugëtimi luftarak i ushtarit më të vogël, rrugëtim që përfundoi në Poloni, ku e kishte thirrur Gjenerali Vasily Chuikov, komandanti i Armatës së 62-të ruse, në të cilën shërbente ushtari i vogël. Gjenerali urdhëroi që djali të dërgohej në shkollën ushtarake "Suvorov" në qytetin e Tulës dhe si suvenir, komandanti ushtarak, i dha Aleshkov-it një pistoletë trofe "Browning". Shkolla Ushtarake "Suvorov", e hapur më 1944, vijoi aktivitetin deri më 1960, duke nxjerrë 900 të diplomuar (nga të cilët 16 gjeneralë dhe 132 kolonelë), ndërkohë që është rihapur sërish më 1.9.2016). Nxënësit e shkollës ishin luftëtarë fëmijë, "bij të regjimenteve" të zbritur nga lufta. Do t'i duhej të përballej me sfida të tjera të jetës përtej misionit të tij në luftë si postës me gazeta e letra, si korrier udhëzimesh, si ndihmës në front, si zbulues të vrojtuesve e zbuluesve të armikut etj. Edhe pse i ri në moshë ai kishte aftësi të kufizuara nga dëmtimet në këmbë dhe më tej Sergej Aleshkov dhe nuk mund të ishte i suksesshëm për ëndrrën e tij ushtarake. Kështu që nuk pati sukses në karrierën e tij ushtarake. Për këtë mori një diplomë juridike dhe jetoi në Urale, por shëndeti i tij vijoi të përkeqësohej. Por pavarësisht kësaj ai punoi në drejtësi dhe me drejtësi, u bë një avokat shumë efektiv, gjithmonë duke përfaqësuar të drejtat dhe interesat e njerëzve të zakonshëm. Në fund të jetës së tij ai punoi si prokuror dhe mbeti njeri i nderuar, duke luftuar vazhdimisht për drejtësi dhe njerëzit e thjeshtë. Ai nuk i harroi kurrë sakrificat e luftës, nderin, ndërgjegjen dhe vëllazërinë ushtarake përgjatë viteve të luftës. Ushtari luftëtar vdiq nga një atak në zemër në vitin 1990, në moshën vetëm 54 vjeçare, por ka ngelur përjetësisht në memorie të njerëzimit, duke u përfshirë masivisht në veprat letrare, historike dhe kinematografike. Ushtari gjashtë vjeçar që luftoi në Luftën e Dytë Botërore në frontin rus ngeli një kujtim i jetës ushtarake, por gjithmonë u quajt "Djali i Regjimentit".

Lufta e Dytë Botërore ishte konflikti më i madh ushtarak në historinë e njerëzimit, në të cilën u përfshinë 78 shtete ose dy herë më shumë se sa në Luftën e Parë Botërore. Makineria luftarake e botës në LIIB përfshiu 110 milion njerëz, pa përfshirë këtu "luftëtarët e shumtë të rezistencës" në mbarë rruzullin tokësor. Dëmet e shkatërrimet e LIIB përlogariten në rreth 935 miliardë dollarë amerikanë, 55 milionë njerëz humbën jetën dhe mbi 30 milionë invalidë. Koalicioni i madh anti-hitlerian ishin SHBA-të,

Britania e Madhe dhe ish-BRSS. Ushtria Gjermane numëronte më tepër se 7,5 milion ushtarë, BRSS kishte të inkuadruar nëpër frontet e ndryshme të luftës afro 10 milionë ushtarë, Ushtria Amerikane rreth 3 milionë trupa, Britania e Madhe 1 milion ushtarë, Franca dhe kështu me radhë shtetet e tjera antifashiste. Historiografia botërore e ka përlogaritur LIIB në 6 vjet e 1 ditë, nga 1.9.1939-2.9.1945, ndërkohë që për shqiptarët lufta filloi në ditën e pushtimit italian më 7.4.1939. Lufta përfshiu rreth 2 miliardë njerëz dhe pati rreth 62 milionë të vrarë. Të gjitha luftërat kanë një çmim të shtrenjtë për popujt, që paguhet me çmimin e gjakut. "Beteja e Stalingradit", ndër më të mëdhatë e njerëzimit ishte një seri betejash midis gjermanëve dhe sovjetikëve, të cilat u zhvilluan nga 23.8.1942 deri më 2.2.1943, në periferi dhe në qytetin e Stalingradit/Vollgogradit. Kishte dështuar marrja nën kontroll e fushave të naftës të Kaukazit për të siguruar sasitë e nevojshme të naftës, për vazhdimin e luftës. Është vlerësuar se ka qenë beteja me më shumë se 1.500.000 njerëz (ushtarë dhe civilë) të vrarë nga të dy palët. Hitleri inkurajonte me

gradim të Fridrich Paulusit në rangun e mareshalit për heroizmin dhe vetëmohim, por tri ditë pas gradimit, më 2 shkurt 1943 Marshali von Paulus u detyrua t'u dorëzohej sovjetikëve bashkë me 22 gjeneralë dhe 91.000, ushtarët e mbetur të ushtrisë naziste në këtë front. Beteja 200-ditore e Stalingradit e zhvilluar në rreth 100 mijë km/katrorë, tejkaloi të gjitha betejat e mëparshme të historisë së botës, ku u përballën mbi 2.1 milionë trupa gjatë gjithë betejës. Gjeneralët e Stalinit, Mareshali Zhukov dhe Aleksandër Vasiljevski edhe pse qyteti u bom-

bardua masivisht nga forcat ajrore gjermane mundën ta shtonin ushtrinë e tyre, të rrisnin potencialin dhe u mbështetën me ndihmë edhe nga aleati i tyre SHBA. Historianët kanë shkruar gjatë për qëndresën e Stalingradit, sikurse edhe për ndëshkimin e ushtarëve që tregonin "dobësi", sepse në fakt urdhri ishte "kushdo që tërhiqej nga beteja të pushkatohej" dhe statistikisht shpesh janë edhe kontradiktore mbi trupat ruse që u vranë në këtë mënyrë. Nga ana tjetër edhe kur gjermanët zotëruan 88% të qytetit në nëntor 1942, kishte harruar se rezistenca e Ushtrisë së Kuqe sovjetike nuk do të rrëzohej bashkë me qytetin e shkatërruar, por do mbijetonte me të gjithë mënyrat duke kthyer raportin e forcave dhe mjeteve në favor të tyre. Faktet flasin për triumfatorët e Luftës së Dytë Botërore u luftua nga viti 1939 deri në vitin 1945 midis fuqive të "Boshtit" (Gjermani, Itali, Japoni) dhe "Aleatëve" (Britaninë, SHBA dhe Bashkimin Sovjetik etj.). Nga rreth dy milionë njerëz vdiqën në Stalingrad dhe Betejën e Kurskut, si beteja më e madhe e tankeve në histori, me mbi 6000 mjete të blinduara të përfshira, deri në ditët tona vjen një histori e vërtetë e "ushtarit më të vogël në moshë nën uniformë në Betejën e Stalingradit".

27 janari

Dita Ndërkombëtare e Holokaustit

Asambleja e Përgjithshme e OKB-së caktoi 27 janarin si "Ditën Ndërkombëtare të Përkujtimit të Holokaustit". Kjo datë përkon me përvjetorin e çlirimit të kampeve të vdekjes Auschwitz-Birkenau nga forcat sovjetike në vitin 1945.

Udhëheqësi i Gjermanisë naziste, Adolf Hitler vrau të paktën 1,1 milionë njerëz, shumica e tyre hebrenj, në jug të Polonisë.

Holokausti ishte gjenocidi i hebrenjve europianë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Midis viteve 1941 dhe 1945, Gjermania Naziste dhe bashkëpunëtorët e saj vranë sistematikisht rreth gjashtë milion hebrenj në të gjithë Europën e pushtuar nga Gjermania, rreth dy të tretat e popullsisë hebraike të Europës.

Hitleri në librin e tij "Lufta ime" shkruan se raca gjermane është racë pasardhëse e racës ariane (popull që ka jetuar shumë vite më parë-qytetërim i zhdukur tanimë) dhe racë e pastër dhe si e tillë duhet ta sundojë botën... disa popuj duhet të zhduken nga faqja e dheut, hebrenjtë, romët dhe sllavët.

Hitleri gjatë Luftës së Dytë Botërore kishte krijuar shumë burgje dhe kampe përqendrimi. Kampet kishin filluar të hapen që nga viti 1940. Ndër kampet më të njohura ishin: Kampi i Aushvicit, Dahaut, Mauthausenit, Belsenit.

Në këto kampe ishin vendosur njerëz nga të gjitha vendet e pushuara nga blloku nazi-fashist.

Në këto kampe, u mbytën, u torturuan, dhe u bënë eksperimente të gjalla në fushën medicinale. Shumë njerëz për të mos parë skenat e tilla dhe për të mos përjetuar torturat e tilla bënë vetëvrasje.

Në Belsen, nga Holanda, ishte depërtuar edhe 15-vjeçarja (hebrenje) me familjen e saj prej 4 anëtarësh. Ajo kishte mbajtur ditar gjatë kohës që ishte e izoluar në bodrumin e një firme në Belsen. Ajo gjithashtu tregon torturat që ushtronin nazistët, dhe rrethanat e kohës. Ditari i Ana Frankut është

Një datë... Një histori me emrin famëkeq Auschwitz-Birkenau



panorama e gjallë e mynxyrës naziste. Vrasjet me bomba, armë zjarri, pushkatimet, mbytjet me tortura... ishin bërë të zakonshme.

Tani terrori ndaj njerëzve në kampet e përqendrimit kishte ndërruar formën. Nazistët donin t'i mbysnin njerëzit pa lënë gjurmë. Prandaj, filluan asgjësimin e tyre nëpërmjet helmimit masiv në dhomat me gaz në shumicën e kampeve të përqendrimit. Mbytja me gaz brenda një dite arrinte deri në 20.000 njerëz. Trupat e pajetë të njerëzve hidheshin në furra me temperatura të larta, për të zhdukur çdo gjurmë. Shumica e këtyre njerëzve ishin hebrenj.

Sipas statistikave gjatë holokaustit, në kampin e Aushvicit, u vranë mbi 2.000.000 hebrenj. Përveç hebrenjve, në kampet e përqendrimit u vranë dhe u zhdukën edhe pjesëtarë të popujve të tjerë. Këtu numërohen rreth 2.600.000 polakë, 750.000 rusë, 750.000 rumunë, 402.000 hungarezë, 180.000 çekë dhe sllovakë, 108.000 holandezë, 104.000 lituanëzë. Në disa vende të Europës, popullsia vendase i dorëzonte vetë hebrenjtë në duar të nazistëve. Por pati popuj të atillë që i fshihnin dhe strehonin dhe i mbronin

hebrenjtë. Shembulli më i njohur janë shqiptarët. Hebrenjtë në Shqipëri kaluan mirë dhe nuk përjetuan fatin tragjik të bashkëkombësve të tyre. Shqiptarët i mbrojtën aq shumë hebrenjtë sa që i mbajtën edhe në familjet e tyre. Kjo ndodhi në shumë qytete të Shqipërisë si në Tiranë, Shkodër, Durrës, Vlorë, Krujë, Shkup, Prishtinë, etj. Numri i hebrenjve që gjetën shpëtim në Shqipëri shkon më shumë se 2.270. Ndërmjet viteve 1933 dhe 1944, Shqipëria në juglindje të Europës shpëtoi jo vetëm hebrenjtë e vet por edhe çdo hebre që mund të arrinte në kufijtë e saj. Ata nuk u dëbuan dhe as nuk u dorëzuan. Hebrenjtë nuk u grabitën dhe askush nuk e mori pasurinë e tyre. As edhe një ligj zyrtar nuk i shqetësoi ata.

Po sot në kujtim të këtij terrori makabër bëhet thirrje për përpjekje më të mëdha për të luftuar rastet e mungesës së tolerancës, duke theksuar rëndësinë e edukimit të rinisë me konceptin e të drejtave të njeriut. Shtetet duhet të krijojnë programe edukative për të ngulitur kujtimin e Holokaustit tek brezat e ardhshëm, për të parandaluar raste të reja të gjenocidit.



Ti ke forcën që nderon kombin!